



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.150

5 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 155 datë 15.10.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”	6783
Ligj nr.10 156 datë 15.10.2009	Për miratimin e “Marrëveshjes minerare të shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “OTTO-AL, sh.p.k-së”	6787
Ligj nr.10 162 datë 15.10.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”	6796
Ligj nr.10 163 datë 15.10.2009	Për miratimin e “Marrëveshjes minerare të shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “SEASIF GROUP, sh.p.k-së”	6802
Ligj nr.10 164 datë 15.10.2009	Për autoritetin rrugor shqiptar	6810
Ligj nr.10 165 datë 15.10.2009	Për përcaktimin e moshës së daljes në pension të punonjësve të nëntokës	6814
Ligj nr.10 166 datë 15.10.2009	Për disa ndryshime në ligjin nr.8306, datë 14.2.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar	6815
Vendim i KM nr.984, datë 30.9.2009	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve dhe “Master i nivelit të parë”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010	6816

Udhëzim i MPÇSSHB nr.1456/2, datë 29.9.2009	Për një shtesë në udhëzimin nr.1456, datë 28.7.2009 “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të përkujdesit shoqëror”	6823
Vendim i GJK nr.28, datë 2.10.2009	Me objekt shfuqizimi i vendimit nr.509, datë 12.11.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën	6824

LIGJ
Nr.10 155, datë 15.10.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE MBRETËRISË SË SPANJËS PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR
KRIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6303, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS MBI
BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës, në vijim “palët”,
duke pranuar rëndësinë e thellimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit për të luftuar krimin në format e ndryshme të tij;

duke dëshiruar në bazë të traktatit për miqësinë dhe bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës dhe, bërë më datë 22 nëntor 2001, të kontribuojnë në zhvillimin e marrëdhënieve të tyre dypalëshe;

të udhëhequra nga parimet e barazisë, reciprocitetit dhe asistencës së ndërsjellë,
kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

1. Palët, sipas legjislacionit të tyre kombëtar dhe sipas kësaj Marrëveshjeje mbi bashkëpunimin, do të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit, veçanërisht për format e organizuara të tij.

2. Palët do të bashkëpunojnë në luftën kundër formave të aktiviteteve kriminale, veçanërisht kundër:

- a) terrorizmit;
- b) krimeve kundër jetës dhe integritetit të personave;

- c) trafikut të paligjshëm, prodhimit dhe tregtimit të drogave dhe substancave psikotrope, si edhe lëndëve të para dhe perkursorëve për prodhimin e tyre;
- d) imigrimit të paligjshëm dhe trafikut të qenieve njerëzore dhe shkeljes së regjimit të pasaportave dhe vizave;
- e) ndalimit të paligjshëm të personave dhe rrëmbimit të fëmijëve;
- f) falsifikimit (prodhim, tjetërsim), përdorimit të paligjshëm të dokumenteve të identitetit (pasaportave, vizave dhe dokumenteve lidhur me mjetet motorike) dhe shpërndarjes mashtruese të monedhës, mjeteve të pagesës, çeqeve dhe letrave me vlerë;
- g) kontrabandës;
- h) pastrimit të parave;
- i) falsifikimit (prodhim, tjetërsim) dhe shpërndarjes mashtruese të monedhës, mjeteve të pagesës, çeqeve dhe letrave me vlerë;
- j) vjedhjes së mjeteve motorike dhe tregtisë së paligjshme me to dhe aktiviteteve kriminale të lidhura me to;
- k) trafikut të paligjshëm të armëve, municionit, lëndëve plasëse, lëndëve të para strategjike, (materialeve bërthamore dhe radioaktive), si edhe substancave të tjetra përgjithësisht të rrezikshme, dhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë;
- l) trafikut të paligjshëm të objekteve kulturore me vlerë historike dhe veprave të artit;
- m) akteve kriminale kundër financave publike, përfshirë evazionin fiskal;
- n) formave të organizuara të krimit kundër lirisë seksuale, veçanërisht atyre që lidhen me minorenët, si edhe shtypjen, përhapjen dhe dhënien e materialeve pornografike me pjesëmarrjen e minorenëve;
- o) akteve kriminale me futjen në sistemet kompjuterike;
- p) veprave penale kundër burimeve natyrore dhe ambientit.

3. Palët do të bashkëpunojnë gjithashtu në luftën kundër llojeve të tjera të krimeve, parandalimi, zbulimi dhe hetimi i të cilave kërkojnë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente të të dy shteteve. Palët do të bashkëpunojnë edhe në zbatimin e ndërsjellë të masave të posaçme të mbrojtjes, përfshirë ndryshimin e vendbanimit dhe qëndrimit të personave të mbrojtur në territoret përkatëse të palëve, si edhe në shkëmbimin e përvojave të ekspertëve në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Neni 2

1. Bashkëpunimi ndërmjet palëve, brenda kuadrit të luftës kundër krimit cituar në nenin 1, do të përfshijë shkëmbimin e informacionit dhe dhënien e asistencës në aktivitetin operacional për:

- a) kontrollin dhe verifikimin e identitetit të personave dhe kërkimin për persona të cilët janë zhdukur;
- b) hetimin dhe kërkimin për persona të cilët kanë kryer ose dyshohet se kanë kryer akte kriminale në territorin e cilësdo prej palëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre;
- c) identifikimin e kufomave dhe personave të kërkuar nga policia;
- d) kërkimin në territorin e njëres prej palëve për objekte, efekte ose instrumente të përfshira në krim ose të përdorura në kryerjen e tyre me kërkesën e palës tjetër kontraktuese;
- e) financimin e aktiviteteve kriminale.

2. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë gjithashtu në:

- a) shkëmbimin e informacionit dhe ndihmës së nevojshme për shoqërimin e të dënuarve, personave në kuadrin e Konventës për transferimin e personave me vendim gjykatë;
- b) shkëmbimin e informacionit dhe ndihmës së nevojshme për zhvendosjen e lëndëve radioaktive, lëndëve plasëse dhe armëve;
- c) shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në kryerjen e dorëzimeve të kontrolluara të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope;
- d) shkëmbimin e informacionit dhe ndihmën e ndërsjellë për transferimin ose kalimin tranzit të personave të dëbuar ose personave që u është refuzuar hyrja.

Neni 3

Në mënyrë që të arrijnë synimet e bashkëpunimit, palët:

- a) do të informojnë njëra-tjetrën reciprokisht mbi hetime në proces në forma të ndryshme të krimit të organizuar, përfshirë terrorizmin dhe lidhjet, strukturën, funksionimin dhe metodat e tyre;
- b) kryerjen e veprimtarive të koordinuara dhe do të asistojnë njëra-tjetrën në kuadrin e marrëveshjeve plotësuese të nënshkruara nga organet kompetente;
- c) do të ndajnë informacione mbi metodat dhe format e reja të krimit ndërkombëtar;
- d) do të ndajnë informacionet mbi rezultatet e hetimeve kriminale dhe kronologjike të kryera, si dhe informacione reciproke mbi teknikat, hetimet dhe metodat për luftën kundër krimit ndërkombëtar;
- e) do të mbajnë (mbledhin), kurdo është e nevojshme, takime pune për të përgatitur dhe asistuar në kryerjen e masave të koordinuara.

Neni 4

Palët do të bashkëpunojnë në fushat e specifikuar nga kjo Marrëveshje nëpërmjet:

- a) shkëmbimit të informacionit mbi situatën e përgjithshme dhe tendencat e krimit në shtetet e tyre respektive;
- b) shkëmbimit të eksperiencës në përdorimin e teknologjisë kriminale, si edhe të metodave dhe mjeteve të hetimit penal, shkëmbimit të fletëpalosjeve, publikimeve dhe rezultateve të kërkimeve shkencore në fushat e specifikuar nga kjo Marrëveshje;
- c) shkëmbimit të informacionit në fushat që janë përgjegjësi e shërbimeve për mbrojtjen e ligjshmërisë penale dhe shërbimeve të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik dhe luftën kundër krimit;
- d) asistencës teknike dhe shkencore, inspektimeve nga ekspertët dhe dhënia hua për përdorim të pajisjeve të specializuara teknike;
- e) diskutimit të eksperiencave dhe shkëmbimeve të ekspertëve dhe konsultimeve;
- f) bashkëpunimit në fushën e trajnimit profesional.

Neni 5

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të prekin çështjet lidhur me ekstradimin ose lidhur me dhënien e asistencës gjatë gjykimeve.

Neni 6

Organet përgjegjëse për zbatimin praktik të Marrëveshjes janë:

Për palën e Republikës së Shqipërisë: Ministria e Brendshme.

Për Palën e Mbretërisë së Spanjës: Ministria e Brendshme, pa cenuar kompetencat e ndonjë ministrie tjetër.

Neni 7

1. Shkëmbimi i informacionit dhe kërkesat për kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do t'u jepen me shkrim drejtpërsëdrejti organeve kompetente ose nëpërmjet atashëve ose oficerëve ndërlidhës. Për këtë qëllim, palët do të informojnë njëra-tjetrën për emërimin e këtyre të fundit.

Në raste urgjente organet kompetente mund të japin informacion të hollësishëm me gojë, me qëllim zbatimin me përpikëri të kësaj Marrëveshjeje dhe konfirmon modaliteteve me shkrim menjëherë pas kësaj.

2. Kërkesat për shkëmbim informacioni ose për kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të kryhen nga organet kompetente brenda afatit më të shpejtë të mundshëm.

3. Shpenzimi lidhur me plotësimin e një kërkesë ose me kryerjen e një veprimtarie do të merret nga organi kompetent i palës kërkuese.

Neni 8

1. Çdonjëra nga palët mund të refuzojë, tërësisht ose pjesërisht, të plotësojë ose të vendosë kushte në lidhje me respektimin e një kërkesë për ndihmë ose informacion nëse ajo vlerëson se plotësimi i kërkesës paraqet kërcënim për sovranitetin ose sigurinë e saj, ose që ajo është në kundërshtim me parimet bazë të sistemit ligjor të saj (palës), ose me interesat e tjerë themelorë të shtetit.

2. Organi kompetent i palës kërkuese do të informohet rreth arsyes së refuzimit.

Neni 9

1. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet mbi bazën e kushteve të mëposhtme:

a) Pala kërkuese mund ta përdorë informacionin vetëm për qëllimet dhe sipas kushteve të vendosura nga pala e kërkuar, duke marrë në konsideratë limitin kohor pas kalimit të të cilit informacioni duhet të asgjësohet, në pajtim me legjislacionin e saj kombëtar.

b) Me kërkesë të palës së kërkuar, pala kërkuese do të japë informacion rreth përdorimit të të dhënave që u janë dhënë atyre dhe rreth rezultateve të arritura.

c) Nëse do të ndodhte që asaj (palës) i janë dhënë të dhëna të pasakta ose të paplota, pala e kërkuar do të njoftojë pa vonesë palën kërkuese;

d) Secila nga palët do të mbajë një procesverbal për raportet mbi të dhënat e dërguara dhe shkatërrimin e tyre.

2. Palët do të sigurojnë mbrojtje të të dhënave të dërguara kundër së drejtës së paautorizuar për njohjen dhe përdorimin e tyre, tjetërsimit të paautorizuar, publikimit ose përhapjes së paautorizuar në pajtim me ligjin e tyre kombëtar.

Gjithashtu, palët angazhohen me këtë Marrëveshje të mos i japin të dhënat personale të cilave u referohet ky nen ndonjë pale të tretë cilado qoftë të ndryshme nga organi që bën kërkesën që i përket palës kërkuese ose në rastin kur kjo e fundit duhej të zbatonte kërkesën, të dhënat mund t'u transferohen vetëm disa prej organeve të parashikuara në nenin 6 dhe mbi bazën e autorizimit paraprak të palës së kërkuar.

3. Secila palë mund të vërë në dukje në çfarëdo kohë mospajtueshmërinë nga ana e palës kërkuese me dispozitat e këtij neni si një arsye për ta pezulluar në mënyrë të menjëhershme zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe sipas rastit ta shfuqizojë atë automatikisht.

Neni 10

1. Palët do të krijojnë një komitet të përbashkët për të kryer dhe mbikëqyrur bashkëpunimin e rregulluar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje. Organet kompetente do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim rreth përfaqësuesve të cilët ata kanë emëruar si anëtarë të komitetit të përbashkët.

2. Komiteti i përbashkët do të mbledhet, në sesion të rregullt, një herë në vit dhe në sesion të jashtëzakonshëm, me kusht që secila palë të kërkojë këtë, sipas datës, vendit dhe agjendës për të cilën do të bihet dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike.

3. Me përjashtim kur ka një marrëveshje të posaçme ndërmjet palëve, takimet do të mbahen të alternuara në Spanjë dhe në Shqipëri. Takimet do të kryesohen nga kryetari i delegacionit të palës ku mbahet ky takim.

Neni 11

Mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me anë të negociatave ndërmjet palëve.

Neni 12

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të prekin zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, ose angazhimeve në të cilat bën pjesë Mbretëria e Spanjës dhe Republika e Shqipërisë.

Neni 13

Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht tridhjetë ditë që nga data e firmosjes së saj dhe do të hyjë në fuqi ditën e fundit të muajit mbas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit palët informojnë njëra-tjetrën që ata kanë plotësuar kërkesat e ligjit të tyre të brendshëm të nevojshëm për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 14

Këtu përcaktohet që kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në denoncimin nga cilado prej palëve nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të pushojë se qeni e vlefshme gjashtë muaj pas marrjes nga secila prej palëve të njoftimit për denoncim.

Në cilësinë e dëshmisë dhe të provës, përfaqësuesit e të dy shteteve, të autorizuar në mënyrën e duhur për këto qëllime nga qeveritë e tyre respektive, nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 20 maj 2009, në dy kopje identike, në gjuhët shqip dhe spanjisht, duke qenë të dy tekstet njëllorj autentike.

LIGJ

Nr.10 156, datë 15.10.2009

PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE “OTTO-AL, SHPK-SË””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja minerare e shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “OTTO-AL, shpk-së”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6304, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE MINERARE E SHFRYTËZIMIT

E lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Ministri z.Genc Ruli dhe OTTO-AL sh.p.k., shoqëri e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar, me vendimin nr.21020, datë 13.3.1999, me seli në Rrugën e Elbasanit, pallati poshtë Fakultetit të Gjeologjisë, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht për negocimin dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje nga z.Isuf Berberi, administrator.

Duke pasur parasysh që:

- Në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit, qeveria shqiptare i ka dhënë prioritet zhvillimit të zonave industriale lidhur me aktivitetin minerar;

- Legjislacioni në fuqi rregullon aktivitetet minerare dhe marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë nga legjislacioni minerar. Të gjitha të drejtat minerare të siguruar në përputhje me ligjin nr.7796, datë 17.2.1994 “Minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ushtrimit i çdo aktiviteti minerar në Shqipëri bazohet në legjislacionin shqiptar dhe do të ushtrohen në përputhje me të;

- Qeveria e Shqipërisë mirëpret investitorët vendas dhe të huaj për shfrytëzimin e çdo vendburimi minerar, me teknologji të përparuar, me qëllim nxjerrjen e mineraleve, duke përfshirë kërkimin, shfrytëzimin dhe zbulimin brenda një trupi minerar;

- Qeveria e Shqipërisë është deklaruar për një politikë të tërheqjes dhe të mbështetjes së investimeve të huaja. Në zbatim të këtyre politikave ajo është e angazhuar t'i inkurajojë dhe mbështesë ata sa më gjerësisht që të jetë e mundur nëpërmjet sigurimit të bashkëpunimit të të gjitha autoriteteve shtetërore apo institucioneve të tjera nën kontrollin e saj, veçanërisht që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre duke iu përgjigjur brenda një kohe sa më të shkurtër kërkesave të personave juridikë sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ajo angazhohet që të bëjë të mundur që këto organe shtetërore dhe institucione të tjera të mos të vonojnë në mënyrë të paarsyeshme aprovimin e tyre, për të siguruar zhvillimin e infrastrukturës së duhur nga zotëuesi i lejes së shfrytëzimit për të mundësuar investimin për ngritjen dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos.

- Qeveria e Shqipërisë njeh si të vlefshme lejen minerare, e cila jepet nga ministri që mbulon veprimtarinë minerare, duke bërë të mundur zhvillimin e aktivitetit minerar që lidhet me kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve.

- Ligji nr.7796, datë 17.2.1994 “Minerar i Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton marrëdhënien ndërmjet shtetit shqiptar dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë të drejta në bazë të dispozitave të tij dhe të kryejnë aktivitete minerare.

- Ministri është autorizuar të negociojë për nënshkrimin e një marrëveshjeje lehtësuese për investimin e lartpërmendur me zotëuesin e lejes minerare, marrëveshje e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe në vijim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

- Ministri negocion marrëveshjen me zotëuesin e lejes minerare.

Zotëuesi i lejes minerare:

- Është seriozisht i interesuar të ushtrojë aktivitetin minerar dhe për përdorimin e produkteve minerale për qëllime industriale si lëndë të para për prodhimin e çimentos.

- Zotëuesi i lejes minerare, shoqëria OTTO-AL, në bashkëpunim me grupin FASSA, ka krijuar shoqërinë FASSA&BERBERI sh.a., me vendimin nr.36657, datë 30.11.2006, shoqëri e cila me vendimin nr.1 të KRRTRSH-së, datë 17 janar 2008 ka marrë leje për ndërtimin e një fabrike çimentoje në Balldren.

- Ka ndërmarrë studimet tekniko-ekonomike për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt (siç përcaktohet në ligjin minerar të sipërpërmendur), dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos për qëllime industriale;

- Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të ndërmarrë ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos në zonën Balldren, Lezhë dhe zhvillimin e infrastrukturës së lidhur me të, lidhja me rrugën nacionale dhe tunelin për lidhjen e fabrikës me portin e Shëngjinit, duke investuar një shumë prej rreth 200 milionë euro.

Palët:

Bien dakord që të bashkëpunojnë për shfrytëzimin e materialeve ndërtimore (gëlqeror në Balldren dhe argjila në Bushat), në përputhje me lejet minerare të shfrytëzimit me të cilat është pajisur shoqëria e sipërpërmendur, zotëruese e lejes minerare nr.1005, datë 6.4.2007, gëlqerore, lejes minerare nr.1147, datë 4.2.2008, gëlqerore dhe lejes minerare nr.1004, datë 6.4.2006.

Neni 1 **Përkufizime**

Kudo ku janë përdorur termat e mëposhtëm në këtë Marrëveshje, respektivisht, ato do të kenë kuptimet si vijon:

- “Marrëveshje minerare e shfrytëzimit”, kjo marrëveshje me të gjitha shtojcat që përbëjnë pjesë integrale të saj;
- “Zotëruesi i lejes minerare”, shoqëria “OTTO-AL” sh.p.k.
- “Periudha e shfrytëzimit minerar”, periudha kohore e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për 99 vjet.
- “Zona minerare”, sipërfaqet e kërkuara nga zotëruesi i lejes minerare për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt, në zonën e Balldrenit dhe Bushatit, siç përcaktohet në aneksin 1.
- “Projekt”, studimi tekniko-ekonomik për shfrytëzimin minerar.

Neni 2 **Objekti i Marrëveshjes**

Objekti i kësaj Marrëveshjeje do të jetë dhënia zotëruesit e së drejtës për të ushtruar aktivitet minerar në zonën minerare gjatë periudhës së shfrytëzimit minerar dhe gjithashtu përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 3 **Kritere specifike të punimeve**

Plani i investimit do të zbatohet nga zotëruesi i lejes minerare për një kohëzgjatje fillestare prej 4 vitesh, të cilat do të ndahen në dy faza, plus dhe një fazë të tretë të mirëmbajtjes deri në fund të periudhës së shfrytëzimit minerar.

Faza e parë

Punimet përgatitore për hapjen e karierave të gëlqerorëve në Balldren dhe argjilave në Bushat do të kryhen gjatë një periudhe prej 3 vjetësh, me investime në vitin e parë prej rreth 150 000 euro, në vitin e dytë 150 000 euro dhe në vitin e tretë 200 000 euro. Studimet teknike, projektimi dhe punimet përgatitore (shpimet gjeologjike dhe gjeoteknike, rrugët e hyrjes etj.) për hapjen e karierave dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos kanë filluar aktualisht dhe pritet që të përfundojnë brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Faza e dytë

Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e çimentos do të bëhet paralelisht me fazën e parë dhe gjatë një periudhe totale prej 3.5 vitesh, me një investim total prej rreth 200 milionë eurosh, duke përfshirë edhe vlerën e pajisjeve dhe makinerive punuese në kariera.

Investimet që lidhen me karierat do të kryhen paralelisht dhe do të përfundojnë jo më vonë se përfundimi i fabrikës për prodhimin e çimentos.

Investimet gjatë kësaj faze të dytë do të ndjekin radhën e treguar në tabelën në vijim:

Viti	Aktivitetet	Shuma në milion euro
2008	Përfundimi i marrëveshjes për ndërtimin me çelsa në dorë të fabrikës për prodhimin e çimentos, parapagimi i kontraktorit. Përfundimi i projektit të rrugëve që lidhin karierat me fabrikën dhe fabrikën me autostradën, dorëzimi i kërkesës për lejet përkatëse dhe dhënia e lejeve. Projektimi i pjesës më të madhe të strukturave (prej betoni dhe çeliku) dorëzimi i kërkesës për lejet përkatëse tek autoritetet dhe dhënia e lejeve. Shpimet për ujë.	15
2008	Përfundimi i projektimit të strukturave (prej betoni dhe çeliku), dorëzimi tek autoritetet i kërkesës për lejet përkatëse dhe dhënia e lejeve. Punime dherash në zonën e fabrikës, ndërtimi i rrugëve, punime dherash paraprake për zhvillimin e karierave. Mobilizimi i kampit për punëtorët e huaj. Ndërtimi i sistemit të rrugëve të brendshme. Ndërtimi i disa bazamenteve betoni dhe montimi i 20% të strukturës prej çeliku.	40
2009	Projektimi i ndërtesave joprodhuese, dorëzimi i kërkesës për lejet përkatëse tek autoritetet dhe dhënia e lejeve. Projektimi dhe punimet përgatitore për tunelin. Ndërtimi i strukturave prej betoni dhe montimi i disa strukturave prej çeliku dhe pajisjeve.	50
2010	Përfundimi i ndërtimit të strukturave prej betoni dhe montimi i strukturave prej çeliku dhe pajisjeve. Instalimi elektrik, elektronik dhe lidhjet. Ndërtimi i disa ndërtesave joprodhuese. Hapja e tunelit për lidhjen me portin.	55
2011	Përfundimi i ndërtesave joprodhuese. Përfundimi i të gjitha instalimeve. Prova në boshllëk dhe teste prodhimi. Fillimi i prodhimit. Përfundimi i tunelit.	40

Faza e tretë

Punimet për mirëmbajtjen dhe investimet për rrugët e brendshme të karierave të gëlqerorit dhe argjilave në Balldren dhe në Bushat do të bëhen gjatë periudhës së mbetur deri në fund të shfrytëzimit mineral, sipas nevojës.

Bilancet vjetore do të përdoren si dokumente bazë për monitorimin e investimit.

Neni 4

Fillimi i ndërtimit

Zotëruesi i lejes minerare duhet të fillojë ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Një fillim i tillë do të kushtëzohet nga disponueshmëria e tokës për qëllimet e ndërtimit të fabrikës për kohëzgjatjen e këtij koncesioni mineral të zgjatur, si dhe dhënien e të gjitha lejeve dhe licencave, të nevojshme për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos, nga të gjitha autoritetet kompetente.

Neni 5

Detyrimet dhe të drejtat e zotëruesit të lejes minerare

Zotëruesi i lejes minerare është i detyruar:

-Të zbatojë punimet për shfrytëzimin e karierave në përputhje me projektin e investimit, sipas dispozitave të nenit 3, nëse autoritetet shtetërore kompetente nuk e kanë refuzuar padrejtësisht dhënien e të gjitha licencave dhe lejeve të nevojshme si për karierat, ashtu edhe për fabrikën për prodhimin e çimentos.

-Të sigurojë ecurinë normale dhe drejtimin e punimeve, ndërsa do të mbajë Ministrinë vazhdimisht të informuar përsa i përket procesit minerar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit minerar në fuqi.

-Të paguajë të gjitha detyrimet fiskale, taksat dhe pagesat e tjera që burojnë nga zbatimi i këtij aktiviteti ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

-Të zbatojë të gjitha aktet ligjore dhe normative në fuqi për mbrojtjen e ambientit në Republikën e Shqipërisë.

Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë:

Në përputhje me nenin 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, të ndryshuar, palët, me qëllim që të sigurojnë një zhvillim të mirëbalancuar të aktivitetit minerar të shfrytëzimit në Shqipëri (hapjen e një kariere për minerale apo materiale ndërtimi) dhe mbrojtjen në mënyrë të përshtatshme të investimit të zotëruesit të lejes minerare dhe aktivitetin e zotëruesit të lejes minerare në kuadër të investimit për ndërtimin dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos, bien dakord që zotëruesi i lejes minerare për një periudhë prej 99 vitesh (pas firmosjes së kësaj marrëveshjeje dhe aprovimit të saj nga Kuvendi i Shqipërisë) do të ketë të drejtën ekskluzive ta ushtrojë këtë aktivitet shfrytëzimi minerar në zonën minerare, sipas përcaktimeve të mësipërme.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

- Ministria garanton se ajo ka kompetenca dhe autoritet ligjor të plotë për ta firmosur këtë Marrëveshje.

- Ministria garanton përdorim të pacenuar dhe të papenguar të sipërfaqeve të tokës, objekt i kësaj Marrëveshjeje, për periudhën e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje (sipas aneksit 1), pjesë e kësaj kontrate.

- Sipërfaqet e tokës bujqësore (sipas shkresave të Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MMPAU) shkresa nr.4616/2 prot., dhe nr.4615/2 prot., datë 28.10.2008), brenda sipërfaqes së paraqitur në aneksin 1 të kësaj kontrate, nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

- Ministria garanton që sipërfaqet e karierave do të jenë të lira nga pretendimet e palëve të treta për ndonjë peng, pengesë apo barrë të çfarëdolloji, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucionet e mëposhtme:

- ZRPP Shkodër, shkresa nr.1638/1 prot., datë 5.12.2007 dhe ZRPP Lezhë nr.1659/1 prot., datë 5.12.2007 dhe shkresa nr.1658/1, datë 5.12.2007.

- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MMPAU), shkresat nr.4616/2 prot., dhe nr.4615/2 prot, datë 28.10.2008.

- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), shkresa nr.3995/1, prot., datë 29.10.2008, shkresa nr.4587 prot., datë 31.12.2008.

- Komuna Balldren, Lezhë nr.487 prot., datë 17.10.2008, nr.75 prot., datë 23.2.2009.

- Komuna Bushat, Shkodër, shkresa nr.1234/1 prot., datë 31.10.2008.

Pjesët e evidentuara si pronë private (sipas shkresave të sipërpërmendura dhe të evidentuara sipas aneksit 1, pjesë e kësaj kontrate), nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Bazuar në nenin 88 të ligjit "Minerar i Shqipërisë", nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, marrëdhëniet ndërmjet zotëruesve të lejeve minerare dhe çdo pronari të mundshëm brenda sipërfaqes së tokës të karrierave, rregullohen sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

- Ministria merr përsipër që të ndihmojë zotëruesin e lejes minerare për marrjen në rrugë ligjore të të gjitha lejeve dhe licencave për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe të lidhjes rrugore të saj me karrierat, me rrugët nacionale, me portin dhe tregun, nga autoritetet shtetërore apo institucione të tjera nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të ndihmojë që këto leje të jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Kohëzgjatja e shfrytëzimit minerar

Ministria i garanton zotëruesit të lejes minerare të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për një kohëzgjatje prej 99 vitesh. Kjo periudhë kohore do të fillojë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje pas nënshkrimit të saj, aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 8

Programi i punimeve

Zotëruesi i lejes minerare garanton se do të kryejë investimet e parashikuara në planin e ndërtimit dhe të shfrytëzimit, me qëllim realizimin e objektit të kësaj Marrëveshjeje. Projekti do të zbatohet sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas planit përkatës të investimit të paraqitur (aneksi 2).

Neni 9

Përfundimi i marrëveshjes së shfrytëzimit minerar

Ministria mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje kur ajo gjykon se kanë ndodhur shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të ndërmarra nga zotëruesi i lejes minerare, të tilla që mund të bëjnë të pamundur vijimin e punimeve sipas parashikimit në planin e shfrytëzimit minerar. Kur vihen re shkelje që mund të çojnë në pamundësi të vijimit të punimeve, ministria duhet të njoftojë zotëruesin e lejes minerare rreth këtyre shkeljeve dhe të presë 30 ditë për një përgjigje shpjeguese.

Mosplotësimi i ndonjërit nga detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të konsiderohet që është një shkelje e kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që kjo mospërmbyllje vjen si pasojë e një ngjarjeje që konsiderohet si forcë madhore dhe kur është provuar se pala e prekur nga kjo ngjarje: (a) ka marrë të gjitha masat parandaluese të arsyeshme, si dhe të gjitha hapat e nevojshëm për të zbatuar termat dhe konditat e kësaj Marrëveshjeje; dhe (b) ka informuar menjëherë palën tjetër për ndodhinë e kësaj ngjarjeje.

“Një ngjarje forcë madhore” do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë apo kombinim i tyre, që pengon plotësisht apo pjesërisht secilën nga palët për plotësimin e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm nëse dhe në atë masë që një ngjarje apo rrethanë e tillë është përtej kontrollit të arsyeshëm direkt apo indirekt të palës së prekur, nuk është shkaktuar nga një shkelje apo paafësi e saj dhe nuk mund të ishte parandaluar nga çfarëdo masë e arsyeshme që kjo palë mund të kishte ndërmarrë.

Ngjarja “forcë madhore” përfshin ngjarjet në vijim, por nuk kufizohet me to, me konditën që ato të plotësojnë termat e sipërpërmendur:

i) Çdo akt lufte (i deklaruar apo jo), luftë civile, pushtim, konflikt i armatosur apo veprim i armikut të jashtëm, kryengritje apo terrorizëm që përfshijnë apo ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Shqipërisë;

ii) Revolucion, protesta, rebelim ose çdo lloj revolte civile, akte terrorizmi apo sabotazhi, të cilat në çdo rast përfshijnë apo ndikojnë direkt në Republikën e Shqipërisë;

iii) Greva të shpërndara gjerësisht dhe/ose në shkallë politike, kombëtare;

iv) Kontaminim bërthamor, kimik ose biologjik, të cilat direkt apo indirekt ndikojnë në sipërfaqen objekt të kësaj marrëveshjeje, përveç rasteve kur shkaku i këtij kontaminimi vjen si rezultat i veprimeve të shoqërisë ose kontraktorëve të saj;

v) Epidemitë ose infeksionet, të cilat direkt ose indirekt ndikojnë në zonën e lejes minerare dhe ushtrimit të aktivitetit të prodhimit të çimentos.

Në raste vonesash të shkaktuara nga ministria ose nga ndonjë organ tjetër shtetëror, i cili kryen funksionet e tij në lidhje të drejtpërdrejtë me lëshimin e licencave dhe lejeve të tjera ndërtimore të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos ose vonesa të pajustificuara të shkaktuara nga organe të tjera qeveritare gjatë kryerjes së funksioneve që lidhen me këtë Marrëveshje dhe që nuk janë nën kontrollin e shoqërisë, periudha e vonesës nuk do të llogaritet në kuadrin e afateve kohore të vendosura më sipër.

Në rastet e forcës madhore, afatet kohore të përmendura në nenin 3 të mësipërm për zotëruesin e lejes minerare do të shtyhen në përputhje me të, por në asnjë rast kjo nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës së shfrytëzimit mineral, e cila mund të shtyhet vetëm sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Kontrolli dhe investimi

Ministria ka të drejtën dhe detyrimin që të kontrollojë rregullisht zbatimin e Marrëveshjes sipas kushteve të parashikuara në të dhe në përputhje me detyrimet e saj që rrjedhin nga ligji “Minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994.

Ministria dhe zotëruesi i lejes minerare do të përcaktojnë së bashku mënyrën më të mirë të kontrollit, duke siguruar në të gjitha rastet që ky aktivitet nuk do të paraqesë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e projektit. Zotëruesi i lejes minerare do të japë çdo shpjegim teknik që kërkohet.

Zotëruesi i lejes minerare do të vërë në dispozicion të ministrisë pasqyrat financiare vjetore të tij, të hartuara në përputhje me standardet e kontabilitetit, për qëllimin e verifikimit të zbatimit të investimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në çdo rast, kur ministria identifikon shkelje, ajo do t’ia komunikojë me shkrim, në mënyrë mjaftueshmërisht të hollësishme, vërejtjet dhe gjetjet e saj zotëruesit të lejes minerare, me kërkesën që punimet duhet të vazhdojnë sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje, duke vënë në dispozicion kohën e mjaftueshme për ndreqjen e tyre sipas rastit.

Neni 11

Ligji i aplikueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ministria garanton se të drejtat e zotëruesit të lejes minerare sipas kësaj Marrëveshjeje që lidhen me shfrytëzimin e karrierave për një periudhë prej 99 vitesh dhe përdorimi i tokës për një periudhë prej 99 vitesh do të zgjasë dhe do të vijojnë të qëndrojnë në fuqi, pavarësisht çdo ndryshimi të dispozitave ligjore që lidhen me to, të aplikueshme në Shqipëri që do të hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje, e cila mund të ngrihet nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshje gjatë zbatimit të saj, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok ndërmjet palëve, do të zgjidhet përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), nga një apo tre arbitra, që do të emërohen sipas rregullave të sipërpërmendura.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Paris, Francë dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

Neni 13
Bashkëpunimi

Ministria dhe zotëruesi i lejes minerare bien dakord që të bashkëpunojnë me qëllimin për të garantuar zbatimin e projektit siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera ndërmjet palëve duhet të dërgohen në adresat respektive të palëve.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas firmosjes së saj nga palët dhe pasi ajo të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar.

Në emër të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Kristo Rodi Drejtor i Përgjithshëm	Në emër të shoqërisë “OTTO-AL” sh.p.k. Isuf Berberi Administrator
---	--

ANEKSI 1

Sipërfaqet (të shprehura në koordinata) e kërkuara nga zotëruesi i lejes minerare për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt, në zonën “Balldren”, rrethi Lezhë, siç përcaktohet në nenin 1 “Përkufizime, zona minerare” të marrëveshjes minerare të shfrytëzimit lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “OTTO-AL” sh.p.k.

1. Koordinatat që përcaktojnë sipërfaqen e karierës së gëlqerorëve në vendburimin “Balldren”, Lezhë në lejen e shfrytëzimit nr.1005, datë 6.4.2007.

Koordinatat e karierës së gëlqerorëve		
Pika	Y	X
1	43 83 000	46 33 000
2	43 83 560	46 33 575
3	43 85 075	46 32 050
4	43 84 500	46 31 500
Sipërfaqja = 1.7 km ²		

2. Koordinatat që përcaktojnë sipërfaqen e karierës së gëlqerorëve në vendburimin “Balldren”, Lezhë në lejen e shfrytëzimit nr.1147, datë 4.2.2008.

Koordinatat e karierës së gëlqerorëve		
Pika	Y	X
1	43 82 596	46 34 500
2	43 82 901	46 34 914
3	4384 648	46 33 176
4	43 84 260	46 32 800
Sipërfaqja = 1.280 km ²		

3. Koordinatat që përcaktojnë sipërfaqen e karierës së argjilave në vendburimin “Bushat”, Shkodër.

Koordinatat e karierës së argjilave		
Pika	Y	X
1	43 77 456	46 49 849
2	43 77 607	46 49 847
3	43 77 648	46 49 767
4	43 77 720	46 49 741
5	43 77 762	46 49 851
6	43 77 997	46 49 845
7	43 77 942	46 49 751
8	43 78 043	46 49 685
9	43 78 145	46 49 627
10	43 78 199	46 49 684
11	43 78 041	46 49 852
12	43 78 199	46 49 852
13	43 78 648	46 49 401
14	43 78 567	46 49 369
15	43 78 540	46 49 257
16	43 78 499	46 49 081
17	43 78 523	46 48 950
18	43 78 450	46 48 873
Sipërfaqja = 0.475458 km ²		

Toka bujqësore e evidentuar sipas shkresave:

- ZRPP Shkodër shkresa nr.1638/1 prot., datë 5.12.2007; dhe
 - ZRPP Lezhë nr.1659/1 prot., datë 5.12.2007 dhe shkresa nr.1658/1, datë 5.12.2007;
 - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), shkresa nr.3995/1 prot., datë 29.10.2008, shkresa nr.4587 prot., datë 31.12.2008;
 - Komuna Balldren, Lezhë nr.487, prot., datë 17.10.2008, nr.75 prot., datë 23.2.2009;
 - Komuna Bushat, Shkodër, shkresa nr.1234/1 prot., datë 31.10.2008;
- bazuar në shkresat nr.4616/2 prot., dhe nr.4615/2 prot, datë 28.10.2008 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MMPAU), nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Gjithashtu tokat me pronësi private të evidentuara si më sipër, nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

LIGJ
Nr.10 162, datë 15.10.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ÇEKISË PËR
BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6310, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ÇEKISË PËR BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR
KRIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Çekisë (të referuara më poshtë si “Palë kontraktuese”),

të ndërgjegjshme për rrezikun nga shtrirja e krimit ndërkombëtar, në veçanti nga përdorimi dhe trafikimi i drogave narkotike dhe substancave psikotrope në nivel ndërkombëtar;

të bindura se bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ose në parandalimin e tyre, është i një rëndësie thelbësore;

të vetëdijshme mbi natyrën serioze të rritjes së migracionit të paligjshëm dhe rreziqet për sigurinë, të lidhura me të;

duke dëshiruar ta zhvillojnë në mënyrë efektive bashkëpunimin dypalësh;

në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe legjislationin e tyre kombëtar përkatës, kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

1. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë në përputhje me legjislationin e tyre kombëtar dhe detyrimet ndërkombëtare të shteteve të tyre në parandalimin dhe zbulimin e krimeve dhe

autorëve të krimit, duke u fokusuar në luftën kundër krimit të organizuar.

2. Në përputhje me paragrafin 1, palët kontraktuese do të bashkëpunojnë për të luftuar:

- a) krimet kundër jetës dhe shëndetit;
- b) terrorizmin dhe financimin e tij;
- c) trafikimin e qenieve njerëzore, shfrytëzimin e prostitucionit, trafikimin e paligjshëm të organeve dhe indeve të qenieve njerëzore;
- d) abuzimin dhe pornografinë e fëmijëve;
- e) manifestimin e ekstremizmit, urrejtjes raciale dhe ksenofobisë;
- f) trafikun e paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope (Vjenë, 20 dhjetor 1988);
- g) prodhimin e paligjshëm, mbledhjen, zotërimin, importimin, eksportimin, transportimin dhe tregtimin e paligjshëm të armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, materialeve kimike, biologjike, radioaktive dhe bërthamore, mallrave dhe teknologjive të një rëndësie strategjike dhe me materiale ushtarake, si edhe substanca të tjera me rrezik të lartë, duke përfshirë këtu edhe lëndët me mbetje të rrezikshme;
- h) falsifikimin dhe qarkullimin e monedhave, mjeteve të pagesës jo me para në dorë, falsifikimin e dokumenteve zyrtare, pasaportave, vizave, vulave dhe letrave me vlerë;
- i) transaksioneve financiare të paligjshme, legalizimin e pasurive që burojnë nga krimi;
- j) korrupsionin dhe kontrabandën;
- k) krimin që lidhet me objektet me vlerë kulturore dhe historike;
- l) vjedhjen dhe përvetësimin e mjeteve motorike;
- m) krimet kundër pronësisë intelektuale;
- n) krimin kibernetik.

3. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë gjithashtu në luftën ndaj migracionit të paligjshëm, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe detyrimet ndërkombëtare të shteteve të tyre.

4. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë gjithashtu në përgatitjen për luftën kundër krimit, brenda qëllimit të paragrafit 1 dhe 3.

5. Bashkëpunimi nën këtë Marrëveshje nuk do të përfshijë sigurimin e asistencës ligjore në çështje kriminale, gjë që është brenda kompetencave të organeve gjyqësore.

Neni 2

Gjatë bashkëpunimit, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, palët kontraktuese, në veçanti:

a) Do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi konkluzionet dhe të dhënat në lidhje me krimet, personat e dyshuar dhe të përfshirë në kryerjen e krimeve, lidhjet ndërmjet autorëve të krimit, informacion mbi organizimin dhe strukturën e grupeve që kryejnë krime, sjelljen tipike të autorëve të krimit dhe grupeve kriminale, mbi shkeljen e së drejtës penale dhe masat e miratuara për këtë qëllim;

b) Do t'i sigurojnë njëra-tjetrës informacion mbi aktet terroriste të planifikuara, të drejtuara kundër interesave të shteteve të palëve kontraktuese, dhe mbi grupet terroriste, anëtarët e të cilave planifikojnë, kryejnë ose kanë kryer krime në territorin e shteteve të palëve kontraktuese;

c) Do të bashkëpunojnë për kërkimin e personave që dyshojnë se kanë kryer krim, si edhe ata që përpiqen t'i shmangen përgjegjësisë penale ose t'i shmangen vuajtjes së dënimit;

d) Do të bashkëpunojnë për kërkimin e personave të humbur, përfshirë këtu edhe identifikimin e personave apo kufomave;

e) Do të bashkëpunojnë për identifikimin dhe sekuestrimin e përfitimeve të krimit dhe mjeteve të financimit të terrorizmit;

f) Do të bashkëpunojnë për kërkimin e sendeve;

g) Do të bashkëpunojnë për kryerjen e masave që janë zbatuar në lidhje me programet për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të personave të tjerë që ndodhen nën kërcënim fizik ose ndonjë rrezik tjetër serioz në lidhje me një procedim penal;

h) Do të bashkëpunojnë në monitorimin e dërgesave të kontrolluara për të zgjidhur një vepër penale;

i) Do t'i japin njëra-tjetrës asistencë personale, teknike dhe organizative për parandalimin e krimeve, si dhe zbulimin e autorëve të krimit;

j) Kur është e nevojshme, do të mbledhen në takime pune mbi çështjet penale konkrete nën hetim, si edhe për të përgatitur dhe koordinuar masat;

k) Do të shkëmbejnë informacion mbi rezultatet që dalin nga kërkimet penale dhe kriminologjike, në praktikën e hetimit, metodat dhe mjetet e punës;

l) Do të shkëmbejnë informacion mbi metodat dhe format e reja të kryerjes së krimeve që kalojnë kufijtë e shteteve të palëve kontraktuese;

m) Do t'i japin njëra-tjetrës informacion mbi objektet e përdorura si instrumente të krimit ose produkte të krimit, ose ekzemplarët e tyre;

n) Do të shkëmbejnë informacion dhe do të bashkëpunojnë në fushën e luftës kundër migracionit të paligjshëm;

o) Do të shkëmbejnë rregullore ligjore, dokumente analitike dhe konceptuale, dhe literaturë të specializuar;

p) Do të bashkëpunojnë në fushën e arsimit, edukimit dhe trajnimit të mëtejshëm të punonjësve të policisë dhe shkëmbimin e specialistëve me qëllim rritjen e njohurive të tyre profesionale, mbështetjen për shkëmbimin e përvojës dhe për të mësuar rreth mënyrave dhe metodave për luftimin e krimit.

Neni 3

Organet e mëposhtme do të jenë kompetente për bashkëpunimin nën këtë Marrëveshje brenda përgjegjësisë të tyre (më poshtë referuar si “organet kompetente”):

Në Republikën e Shqipërisë:

- a) Ministria e Brendshme,
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- c) Ministria e Financave,
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Në Republikën Çeke:

- a) Ministria e Brendshme,
- b) Presidiumi Policor i Republikës Çeke,
- c) Ministria e Financave-Seksioni i Financës dhe Analizës,
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Neni 4

1. Palët kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës adresa, numra telefoni dhe faksi dhe kontakte të tjera të organeve kompetente dhe departamenteve të tyre jo më vonë se data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Organet kompetente do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të këtyre të dhënave.

2. Palët kontraktuese do ta njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën mbi çdo ndryshim që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe emrat e organeve kompetente.

Neni 5

1. Asistenca, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të sigurohet sapo të kërkohet. Kërkesa për informacion, mjete, ekzemplarë, si dhe miratimi për masa ose forma të tjera të asistencës, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të dërgohet me shkrim, mundësisht me faks ose postë elektronike nëpërmjet organeve kompetente. Në raste urgjente, kërkesa mund të dërgohet verbalisht e pasuar më pas nga një konfirmim i menjëhershëm me shkrim, mundësisht me faks ose postë elektronike.

2. Organi kompetent i palës kontraktuese kërkuese do ta shqyrtojë kërkesën sipas paragrafit 1, pa vonesë. Organi kompetent i palës kontraktuese, të cilit i drejtohet kërkesa, mund të kërkojë informacione shtesë, nëse është e nevojshme, për të shqyrtuar kërkesën.

3. Në raste të veçanta, organet kompetente të palëve kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës informacion, pa paraqitjen e një kërkesë, nëse mendojnë se informacioni është i rëndësishëm për palën tjetër kontraktuese, me qëllim parandalimin ose zbulimin e krimeve ose autorëve të krimeve.

Neni 6

1. Palët kontraktuese mund ta refuzojnë plotësisht ose pjesërisht kërkesën për asistencë apo formë tjetër bashkëpunimi, sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse pranimi i saj mund të dhunojë sovranitetin e palës kontraktuese, sigurinë apo ndonjë interes tjetër të rëndësishëm ose nëse është në kundërshtim me rregullat kombëtare ligjore apo detyrimet e saj përkatëse ndërkombëtare të shtetit të saj.

2. Nëse kërkesa refuzohet pjesërisht ose plotësisht, palët kontraktuese do ta njoftojnë pa vonesë njëra-tjetrën mbi këtë fakt me shkrim.

3. Palët kontraktuese mund të caktojnë kushte për të pranuar kërkesën, që do të jetë detyruese për palën tjetër kontraktuese.

Neni 7

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, organet kompetente të palëve kontraktuese do të përdorin gjuhën angleze, nëse nuk bien dakord ndryshe.

2. Organet kompetente të palëve kontraktuese do të vlerësojnë bashkëpunimin, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

1. Pas një marrëveshjeje me palën tjetër kontraktuese, secila palë kontraktuese mund të dërgojë oficerë ndërlidhës tek organet kompetente të palës tjetër.

2. Në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese, oficerët ndërlidhës do të japin asistencë dhe këshillim. Ata do të sigurojnë informacion dhe do të përmbushin detyrat e tyre duke zbatuar udhëzimet e dhëna nga pala kontraktuese që i dërgon. Ata do të japin asistencë për krijimin e kontakteve dhe do të marrin pjesë në organizimin e takimeve dypalëshe të punës.

3. Oficerët ndërlidhës të një pale kontraktuese që janë dërguar në një vend të tretë, pas një marrëveshjeje reciproke ndërmjet palëve kontraktuese dhe me miratim me shkrim të vendit të tretë, gjithashtu mund të përfaqësojnë interesat e palës tjetër kontraktuese.

Neni 9

Dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për transferimin e të dhënave personale (më poshtë të referuara si “të dhëna”), si dhe për dorëzimin e tyre:

a) Pala kontraktuese marrëse mund t'i përdorë të dhënat vetëm për qëllim dhe sipas kushteve të përcaktuara nga pala kontraktuese dërguese. Të dhënat mund të përdoren për qëllime të tjera, vetëm me miratimin paraprak me shkrim të palës kontraktuese dërguese.

b) Me kërkesë të palës kontraktuese dërguese, pala kontraktuese marrëse do të japë informacion dhe do të përdorë të dhënat e marra dhe rezultatet e përfuara me ndihmën e të dhënave.

c) Të dhënat do t'u dërgohen, ekskluzivisht, organeve kompetente, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe organeve të tjera kompetente në luftën ndaj krimit apo migracionit të paligjshëm. Zbulimi i të dhënave tek organe të tjera do të mundësohet nëse sigurohet një miratim me shkrim i palës kontraktuese dërguese.

d) Pala kontraktuese dërguese do të jetë e detyruar të sigurojë saktësinë e të dhënave të transferuara dhe të kontrollojë nëse transferimi është i nevojshëm dhe në përputhje me qëllimin për

të cilin është vënë në dispozicion. Nëse konstatohet më vonë se janë transferuar të dhëna të gabuara ose të dhëna që nuk duhet të ishin transferuar, pala kontraktuese marrëse do të njoftohet menjëherë. Pala kontraktuese marrëse do të jetë e detyruar të korrigjojë të dhënat e gabuara ose t'i shkatërrojë ato, në rastin e të dhënave që nuk duhet të ishin transferuar.

e) Personit, të dhënat e të cilit janë transferuar, do t'i jepet me kërkesën e tij ose saj dhe me një miratim paraprak me shkrim të palës tjetër kontraktuese, informacion mbi të dhënat e transferuara dhe përdorimin e tyre të synuar, me kusht që rregullat kombëtare ligjore të palës kontraktuese, të cilës i është kërkuar informacion, të mos e pengojnë atë.

f) Pala kontraktuese marrëse do të jetë e detyruar të shkatërrojë të dhënat e marra nëse nuk i nevojiten më për qëllimin për të cilin ato janë transferuar. Në rast të mbarimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje do të jetë e nevojshme të shkatërrohen të gjitha të dhënat e marra nën të, jo më vonë se data e mbarimit të afatit, nëse nuk zëvendësohet nga një marrëveshje e re.

g) Palët kontraktuese janë të detyruara të regjistrojnë transferimet, marrjet dhe shkatërrimet e të dhënave. Regjistrat duhet të përfshijnë informacion në lidhje me arsyet për transferimin e të dhënave, organet dërguese dhe marrëse, kohën e transferimit, shtrirjen e të dhënave, si dhe informacion mbi shkatërrimin e të dhënave.

h) Palët kontraktuese do të jenë të detyruara të mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat e transferuara nga shkatërrimi aksidental apo i paautorizuar, humbja aksidentale, ndryshimi aksidental apo i paautorizuar, transferimin aksidental apo i paautorizuar, aksesin aksidental apo i paautorizuar, apo zbulimi aksidental apo i paautorizuar.

Neni 10

Nëse, sipas kësaj Marrëveshjeje, transferohet informacion i klasifikuar, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

1. Informacioni, i cili sipas rregullave kombëtare ligjore të palës kontraktuese transferuese, i cili i nënshtrohet klasifikimit të sigurisë dhe mban shënimin sipas rregullave, do të jepet nga pala kontraktuese marrëse me mbrojtje të njëjtë me atë që i jepet informacionit që i nënshtrohet nivelit përkatës të klasifikimit të sigurisë sipas rregullave të tij kombëtare ligjore, në përputhje me tabelën e ekuivalencës së niveleve të klasifikimit të sigurisë të përfshirë në aneksin e kësaj Marrëveshjeje. Aneksi formon një pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

2. Pala kontraktuese transferuese do të njoftojë pa vonesë me shkrim palën kontraktuese marrëse mbi ndonjë riklasifikim apo deklasifikim të informacionit të klasifikuar të transferuar. Pala kontraktuese marrëse do të kryejë riklasifikimin ose deklasifikimin sipas njoftimit.

3. Informacioni i klasifikuar, i transferuar, do të përdoret vetëm në përputhje me qëllimin për të cilin është transferuar dhe do ta kenë vetëm personat që e kanë të nevojshëm ta njohin, të cilët janë autorizuar, sipas rregullave ligjore kombëtare, specifikisht, kur përmbushin kushtet për të pasur akses ndaj informacionit të klasifikuar të nivelit përkatës të klasifikimit të sigurisë.

4. Informacioni i klasifikuar, i transferuar, do të mundësohet edhe për organe të tjera kompetente, të përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe për organe të tjera që merren me luftën kundër krimit dhe migracionit të paligjshëm, vetëm me një miratim me shkrim të palës kontraktuese transferuese.

5. Çdo shkelje e rregullave kombëtare ligjore të Palës kontraktuese marrëse në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të transferuar, do t'i raportohet pa ndonjë vonesë palës kontraktuese transferuese, duke përfshirë informacion mbi rrethanat e shkeljes së rregullave ligjore, pasojat e saj dhe masat e marra për të zbutur pasojat dhe për të parandaluar të tilla shkelje në të ardhmen.

Neni 11

Informacioni dhe dokumentet e transferuara, përfshirë edhe informacionin e klasifikuar për vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, do të sigurohen nëpërmjet miratimit me shkrim të palës kontraktuese transferuese.

Neni 12

Nëse organet kompetente të palës kontraktuese bien dakord paraprakisht:

a) Pala kontraktuese që kërkon asistencë do të mbulojë shpenzimet për zbatimin e bashkëpunimit sipas nenit 2.

b) Pala kontraktuese që i jep asistencë palët tjetër kontraktuese do të mbulojë të gjitha shpenzimet e zbatimit të formave të tjera të bashkëpunimit duke përcaktuar që palët kontraktuese do të tregojnë kujdes mbi balancimin e ndërsjellë dhe reciprocitetin e kostove.

Neni 13

Në rast nevojë, organet kompetente të palëve kontraktuese mund të lidhin protokolle zbatuese nën këtë Marrëveshje dhe në bazë të saj.

Neni 14

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen nëpërmjet organeve kompetente të palëve kontraktuese. Nëse mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me këto mjete, do të zgjidhen më tej ndërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 15

Kjo Marrëveshje nuk cenon detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, me të cilat shtetet e palëve kontraktuese janë të lidhura.

Neni 16

Palët, në çdo kohë, mund të pezullojnë përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht, zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në rast se do të jetë e nevojshme për sigurinë kombëtare, rendin publik ose shëndetin publik. Palët kontraktuese do të njoftojnë pa vonesë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi miratimin apo tërheqjen e një mase të tillë. Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe tërheqja e saj do të hyjnë në fuqi në përfundim të 15 ditëve nga dhënia e një njoftimi të tillë palës tjetër kontraktuese.

Neni 17

1. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për përmbushjen e kushteve ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes që vjen pas marrjes së njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë atë me shkrim në çdo kohë. Marrëveshja do të përfundojë gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij denoncimi nga pala tjetër kontraktuese.

Bërë në Pragë, më 27 prill 2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, çeke dhe angleze. Në rast të mospërputhjeve në interpretim, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

ANEKS

PËR MARRËVESHJEN NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ÇEKE PËR BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT

Në përputhje me nenin 10, a të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit dhe duke marrë në konsideratë rregullat e tyre kombëtare ligjore, palët kontraktuese kanë vendosur se nivelet e mëposhtme të klasifikimit të sigurisë janë në përputhje për nevojat e kësaj Marrëveshjeje.

E KUFIZUAR
KONFIDENCIALE
SEKRET
TEPËR SEKRET

VYHRAZENÉ
DŮVERNÉ
TAJNÉ
PŘISNĚ TAJNÉ

RESTRICTED
CONFIDENTIAL
SECRET
TOP SECRET

LIGJ

Nr.10 163, datë 15.10.2009

PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE “SEASIF GROUP, SHPK-SË””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja minerare e shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “Seasif Group, shpk-së””, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6311, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE MINERARE E SHFRYTËZIMIT

E lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Kristo Rodi, Drejtor i Përgjithshëm, i autorizuar nga Ministri, z. Genc Ruli dhe

Shoqëria “SEASIF GROUP” sh.p.k. është person juridik, regjistruar në QKR në datën 2.12.2007, me numër NIPT-i K81323023V. Adresa e saj është: Rr.Brigada VIII, pallatet teknoprojekt, kati 8, ap.5, Tiranë. Administrator: z.Sokol Kikino, telefon: 0035542254640.

“SEASIF GROUP” sh.p.k. shoqëri e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar e regjistruar në QKR në datën 2.12.2007 me numër NIPT-i K81323023V me seli në adresën: rr.Brigada VIII, pallatet teknoprojekt, kati 8, ap.5, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë z.Sokol Kikino.

Duke pasur parasysh që:

- Në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit, qeveria shqiptare i ka dhënë prioritet zhvillimit të zonave industriale lidhur me aktivitetin mineral;

- Legjislacioni në fuqi, rregullon aktivitetet minerare dhe marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë nga legjislacioni mineral. Të gjitha të drejtat minerare të siguruar në përputhje me ligjin “Minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, të ndryshuar, dhe ushtrimi i çdo aktiviteti mineral në Shqipëri bazohen në legjislacionin shqiptar dhe do të ushtrohen në përputhje me të;

- Qeveria e Shqipërisë mirëpret investitorët vendas dhe të huaj për shfrytëzimin e çdo vendburimi mineral, me qëllim nxjerrjen e mineraleve duke përfshirë kërkimin, shfrytëzimin dhe zbulimin brenda një depozite minerare;

- Qeveria e Shqipërisë është deklaruar për një politikë të tërheqjes dhe mbështetjes së investimeve të huaja. Në zbatim të këtyre politikave ajo është e angazhuar t'i inkurajojë dhe mbështesë ata sa më gjerësisht që të jetë e mundur nëpërmjet sigurimit të bashkëpunimit të gjitha autoriteteve shtetërore apo institucioneve të tjera nën kontrollin e saj, veçanërisht që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre duke iu përgjigjur brenda një kohe sa më të shkurtër kërkesave të personave juridikë sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Ajo angazhohet të bëjë të mundur që këto organe shtetërore dhe institucione të tjera të mos vonojnë në mënyrë të paarsyeshme aprovimin e tyre, për të siguruar zhvillimin e infrastrukturës së duhur nga zotëuesi i lejes së shfrytëzimit për të mundësuar investimin për ngritjen dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos.

- Qeveria e Shqipërisë njeh si të vlefshme lejen minerare, e cila jepet nga ministri që mbulon veprimtarinë minerare, duke bërë të mundur zhvillimin e aktivitetit mineral që lidhet me kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve.

Ligji “Minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, përcakton marrëdhënien ndërmjet shtetit shqiptar dhe personave juridikë, që synojnë të përfitojnë të drejta në bazë të dispozitave të tij dhe të kryejnë aktivitete minerare.

- Ministri është i autorizuar të negociojë për nënshkrimin e një marrëveshjeje lehtësuese për investime lartpërmendur me zotëuesin e lejes minerare, marrëveshje e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe në vijim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

- Ministri negocion marrëveshjen me zotëuesin e lejes minerare.

Zotëuesi i lejes minerare:

- Është seriozisht i interesuar të ushtrojë aktivitetin mineral dhe për përdorimin e produkteve minerare për qëllime industriale si lëndë të para për prodhimin e çimentos;

- Ka ndërmarrë studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt (siç përcaktohet në ligjin mineral të sipërpërmendur), dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos për qëllime industriale;

- Në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të ndërmarrë ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe zhvillimin e infrastrukturës lidhur me të, duke investuar një shumë prej rreth € 191,000,000,00 euro (njëqind e nëntëdhjetë e një milion).

Palët:

Bien dakord që të bashkëpunojnë për shfrytëzimin e materialeve ndërtimore (gurit gëlqeror) në zonën gëlqerore Kakarriq (Mali i Jushit/Fshat i Ri), në përputhje me lejet minerare me të cilat është pajisur shoqëria e sipërpërmendur, zotëruese e lejes minerare dhe sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1

Përkufizime

Kudo ku janë përdorur termat e mëposhtëm në këtë Marrëveshje, respektivisht ato do të kenë kuptimet si vijon:

- Marrëveshje Minerare e Shfrytëzimit: Kjo marrëveshje me të gjitha përkufizimet;
- Zotëruesi i lejes minerare: Shoqëria “SEASIF GROUP” sh.p.k.;
- Periudha e shfrytëzimit mineral: Periudha kohore e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për 99 vjet;
- Zona minerare: Sipërfaqja e kërkuar nga zotëruesi i lejes minerare për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt, në zonën e gëlqerore mali i Kakarriqit, pjesë e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1248, datë 13.10.2008, siç përcaktohet me koordinatat e paraqitura në aneksin nr.1 bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.
- Projekt: Studimi tekniko-ekonomik për shfrytëzimin mineral.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshjeje do të jetë dhënia e zotëruesit e së drejtës për të ushtruar aktivitet mineral në zonën minerare gjatë periudhës së shfrytëzimit mineral dhe gjithashtu përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve për përmbushjen e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 3

Kriteret specifike të punimeve

Plani i investimit do të zbatohet nga zotëruesi i lejes minerare për një kohëzgjatje maksimale prej 3 (tre) vitesh, të cilat do të ndahen në tri (3) faza, plus një fazë të tretë të mirëmbajtjes deri në fund të periudhës së shfrytëzimit mineral.

Faza e parë

Punimet përgatitore për hapjen e karrierave të gëlqerorit në gëlqerore Kakarriq (Mali i Jushit –Fshat i Ri) do të kryhen gjatë një periudhe prej tre (3) vitesh.

Faza e parë A): Studimet e detajuara teknike të karrierave, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve me një investim të përafërt gjatë vitit të parë prej € 450 000 euro (katërqind e pesëdhjetë mijë).

Studimet teknike dhe projektimi dhe shpimet gjeologjike dhe gjeoteknike, për karrierën dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos kanë filluar.

Faza e parë B) Punimet në karriera për impiantin e thyerjes, punime ndërtimi për sheshim dhe rrugët do të fillojnë në 2010. Blerja, montimi dhe fillimi i punës së impiantit të thyerjes që ndodhet në karrier, si dhe makinerive të lëvizshme do të fillojë në vitin 2011.

Vlera e përafërt e investimit në vitin e dytë: € 5 000 000 euro (pesë milionë) dhe në vitin e tretë € 7 500 000 euro (shtatë milionë e pesëqind mijë), specifikuar sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Aktiviteti	Vlera e investimit në milion euro
2009	Studimet të detajuara teknike të karrierave, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e detajuara të mineraleve	0,45
2010	Punimet në karriera për impiantin e thyerjes, punime ndërtimi dhe rrugët	5.0
2011	Makineri fikse, montimi dhe fillimi i punës. Pajisje të lëvizshme	7.5

Faza e dytë

Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e çimentos do të bëhet paralelisht me fazën e parë dhe gjatë një periudhe totale prej rreth 3 vitesh, me një investim total prej rreth €191 000 000 00 euro (njëqind e nëntëdhjetë e një milion).

Investimet që lidhen me karrierat do të kryhen paralelisht dhe do të përfundojnë të paktën 2 muaj para përfundimit të fabrikës për prodhimin e çimentos.

Investimet gjatë kësaj faze të dytë do të ndjekin radhën e treguar në tabelën në vijim:

Viti	Aktiviteti	Vlera në milion euro
2009	Mbyllja e marrëveshjes për ndërtimin e fabrikës së prodhimit të çimentos. Mbyllja e projektit të rrugëve ndërmjet karrierave dhe fabrikës, si dhe midis fabrikës dhe rrugës kryesore, vizatimet përfundimtare të vendosjes, shpimet	1,324
2010	Punimet për kampin e punëtorëve të huaj. Fillimi i punimeve për fjetoret (shtëpitë). Projektet e detajuara teknike për strukturat betonarme dhe ato të çelikut, si dhe të utiliteteve, punime dherash për fabrikën dhe sistemime, fillimi e përfundimi i punimeve për rrugët e brendshme. Përgatitja e shesheve për vendosjen e strukturave të betonit dhe ato metalike si dhe për kullat, siloset e bluarjes, shpimet për ujë etj. Ndërtimi i themeleve. Punimet në karriera për impiantin e thyerjes dhe punime të tjera. Blerja dhe fillimi i montimit të makinerive, punime ndërtimi dhe rrugët. Instalimi i 50% të transformatorëve dhe rrjetit elektrik të tensionit të lartë si dhe montimi i gjeneratorit. Punime të tjera	66,190
2011	Supervizim i montimit të impianteve. Punime dherash dhe punime përgatitore në karrierë për impiantin e thyerjes, punime përgatitore dhe struktura, montimi i një pjese të makinerive të karrierës, montimi i siloseve të betonit, ngritja e ndërtesave joproduuese (zyra etj.). Ndërtimi i impianteve metalike për thyerjen, depozitimin dhe paketimin, si dhe blerja dhe montimi i makinerive dhe pajisjeve kryesore të lidhura me to. Përfundimi i gjithë instalimeve elektrike.	108,299
2012	Përfundimi i punimeve për ndërtesat prej betoni dhe i ngritjes së strukturave të çelikut dhe pajisjeve. Mbarimi i ndërtimit të rrugëve të jashtme. Instalimet elektrike, elektronike dhe lidhja. Mbarimi i ndërtimit të disa ndërtesave jo produuese. Testi pa ngarkesë dhe i prodhimit. Fillimi i prodhimit. Çmobilizimi i kampit të punëtorëve të huaj. Të tjera.	15,388

Faza e tretë

Punimet për mirëmbajtjen dhe investimet për rrugët e brendshme të karrierave të gëlqerorit të Kakarriqit (Mali i Jushit-Fshat i Ri) do të bëhen gjatë periudhës së mbetur deri në fund të shfrytëzimit mineral sipas nevojës.

Vlera e mirëmbajtjes dhe investimeve gjatë kësaj faze të tretë llogaritet mbi shumën prej € 3 000 000 në vit gjatë gjithë ekzistencës së aseteve.

Bilancet vjetore do të përdoren si dokumente për monitorimin e investimit.

Neni 4

Fillimi i ndërtimit

Zotëruesi i lejes minerare duhet të fillojë ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos brenda 7 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Një fillim i tillë do të kushtëzohet nga disponueshmëria e tokës për qëllimet e ndërtimit të fabrikës për kohëzgjatjen e kësaj leje minerare të zgjatur, si dhe dhënien e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos nga të gjitha autoritetet kompetente.

Neni 5

Detyrimet dhe të drejtat e zotëruesit të lejes minerare

Zotëruesi i lejes minerare është i detyruar:

- Të zbatojë punimet për shfrytëzimin e karrierave në përputhje me projektet e investimit, sipas dispozitave të nenit 3, nëse autoritetet shtetërore kompetente nuk e kanë refuzuar padrejtësisht dhënien e të gjitha licencave dhe lejeve të nevojshme si për karrierat ashtu edhe për fabrikën për prodhimin e çimentos.

- Të sigurojë ecurinë normale dhe drejtimin e punimeve, ndërsa do të mbajë ministrinë vazhdimisht të informuar për sa i përket procesit mineral, në përputhje me kërkesat e legjislacionit mineral në fuqi.

- Të paguajë të gjitha detyrimet fiskale, taksat dhe pagesat e tjera që burojnë nga zbatimi i këtij aktiviteti ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

- Të zbatojë të gjitha aktet ligjore dhe normative në fuqi për mbrojtjen e ambientit në Republikën e Shqipërisë.

Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë:

Në përputhje me nenin 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, palët me qëllim që të sigurojnë një zhvillim të mirëbalancuar të aktivitetit mineral të shfrytëzimit në Shqipëri (hapjen e një karriere për materiale ndërtimi) dhe mbrojtjen në mënyrë të përshtatshme të investimit të zotëruesit të lejes minerare dhe aktivitetin e zotëruesit të lejes minerare në kuadër të investimit për ndërtimin dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos, bien dakord që zotëruesi i lejes minerare për një periudhë prej 99 vitesh, nga firmosja e kësaj marrëveshjeje dhe aprovimi i saj nga Kuvendi i Shqipërisë, do të ketë të drejtën ekskluzive ta ushtrojë këtë aktivitet shfrytëzimi mineral në zonën minerare, sipas përcaktimeve të mësipërme.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

- Ministria garanton se ajo ka kompetenca dhe autoritet ligjor të plotë për ta firmosur këtë Marrëveshje;

- Ministria garanton përdorim të pacenuar dhe të papenguar të sipërfaqeve të tokës, objekt i kësaj Marrëveshjeje, për periudhën e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje (sipas aneksit 1, pjesë e kësaj Marrëveshjeje);

- Sipërfaqet e tokës bujqësore (nëse evidentohen të tilla), brenda sipërfaqes së paraqitur në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje, nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

- Nëse ato janë pjesë e sipërfaqes që do të përdoret për ndërtimin e fabrikës së çimentos, ato duhet të transformohen në truall ndërtimi, bazuar në ligjet përkatëse të ndryshme nga ligji “Minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, në organet kompetente për këtë qëllim (KRRT pranë komunave apo KRRTRSH).

- Ministria garanton që sipërfaqet e karrieraeve do të jenë të lira nga pretendime të palëve të treta për ndonjë peng, pengesë apo barrë të çfarëdolloji, (sipas aneksit 1, pjesë e kësaj kontrate) dhe bazuar në shkresën nr.2349/2 prot., datë 15.12.2008 të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Shkodër. Bazuar në nenin 88 të ligjit “Minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, marrëdhëniet ndërmjet zotëruesve të lejeve minerare dhe çdo pronari të mundshëm, brenda sipërfaqes së tokës të karrieraeve, rregullohen sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

- Ministria merr përsipër që të ndihmojë zotëruesin e lejes minerare për marrjen në rrugë ligjore të të gjitha lejeve dhe licencave për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos (nëse nuk janë marrë deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji) dhe të lidhjes rrugore të saj me karrierat dhe tregun, nga autoritetet shtetërore apo institucione të tjera nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të ndihmojë që këto leje të jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Kohëzgjatja e shfrytëzimit minerar

Ministria i garanton zotëruesit të lejes minerare të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për një kohëzgjatje prej 99 vitesh. Kjo periudhë kohore do të fillojë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Programi i punimeve

Zotëruesi i lejes minerare garanton se do të kryejë investimet e parashikuara në planin e ndërtimit dhe të shfrytëzimit me qëllim realizimin e objektit të kësaj Marrëveshjeje. Projekti do të zbatohet sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas planit përkatës të investimit të paraqitur.

Neni 9

Përfundimi i marrëveshjes së shfrytëzimit minerar

Ministria mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje kur ajo gjykon se kanë ndodhur shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të ndërmarra nga zotëruesi i lejes minerare, të tilla që mund bëjnë të pamundur vijimin e punimeve sipas parashikimit në planin e shfrytëzimit minerar. Kur vihen re shkelje, ministria duhet ta njoftojë zotëruesin e lejes minerare rreth këtyre shkeljeve dhe të presë 30 ditë për një përgjigje shpjeguese.

Mosplotësimi i ndonjërit nga detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk duhet të konsiderohet që është një shkelje e kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që kjo mospërmbyllje vjen si pasojë e një ngjarjeje që konsiderohet si forcë madhore, dhe kur është provuar se pala e prekur nga kjo ngjarje (a) ka marrë të gjitha masat parandaluese të arsyeshme, si dhe të gjitha hapat e nevojshëm për të zbatuar termat dhe konditat e kësaj Marrëveshjeje; dhe (b) ka informuar menjëherë palën tjetër për ndodhinë e kësaj ngjarjeje.

“Një ngjarje forcë madhore” do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë apo kombinim i tyre që pengon plotësisht apo pjesërisht secilën nga palët për plotësimin e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm nëse dhe në atë masë që një ngjarje apo rrethanë e tillë është përtej kontrollit të arsyeshëm direkt apo indirekt të palës së prekur, dhe nuk mund të ishte parandaluar nga çfarëdo masë e arsyeshme që kjo palë mund të kishte ndërmarrë.

Ngjarja forcë madhore përfshin ngjarjet në vijim, por pa u kufizuar vetëm me to, me kusht që ato të plotësojnë termit e sipërpërmendur:

i) Çdo akt lufte (i deklaruar apo jo), luftë civile, pushtim, konflikt i armatosur apo veprim i armikut të jashtëm, kryengritje apo terrorizëm që përfshijnë apo ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Shqipërisë;

ii) Revolucion, protesta, rebelim ose çdo lloj revolte civile, akte terrorizmi apo sabotazhi, të cilat në çdo rast përfshijnë apo ndikojnë direkt Republikën e Shqipërisë;

iii) Greva të shpërndara gjerësisht dhe/ose në shkallë politike kombëtare;

iv) Kontaminim bërthamor, kimik ose biologjik të cilat direkt apo indirekt ndikojnë sipërfaqen objekt të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur shkaku i këtij kontaminimi vjen si rezultat e veprimeve të shoqërisë ose kontraktorëve të saj;

v) Epidemitë ose infeksionet, të cilat direkt ose indirekt ndikojnë në zonën e koncesionit.

Në raste vonesash të shkaktuara nga ministria ose nga ndonjë organ tjetër shtetëror, i cili kryen funksionet e tij në lidhje të drejtpërdrejtë me lëshimin e licencave dhe lejeve të tjera ndërtimore të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos ose vonesa të pajustificuara të shkaktuara nga organe të tjera qeveritare gjatë kryerjes së funksioneve që lidhen me këtë Marrëveshje dhe nuk janë nën kontrollin e shoqërisë, periodha e vonesës nuk do të llogaritet në kuadrin e afateve kohore të vendosura më sipër.

Në rastet e forcës madhore, afatet kohore të përmendura në nenin 3 të mësipërm për zotëruesin e lejes minerare do të shtyhen në përputhje me të, por në asnjë rast kjo nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës së shfrytëzimit minerar, e cila mund të shtyhet vetëm sipas dispozitave të legjisllacionit në fuqi.

Neni 10

Kontrolli dhe investimi

Ministria ka të drejtën dhe detyrimin që të kontrollojë rregullisht zbatimin e marrëveshjes, sipas kushteve të parashikuara në të dhe në përputhje me detyrimet e saj që rrjedhin nga ligji “Minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994.

Ministria dhe zotëruesi i lejes minerare do të përcaktojnë së bashku mënyrën më të mirë të kontrollit, duke siguruar në të gjitha rastet që ky aktivitet nuk do të paraqesë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e projektit. Zotëruesi i lejes minerare do të japë çdo shpjegim teknik që kërkohet.

Zotëruesi i lejes minerare do të vërë në dispozicion të ministrisë pasqyrat financiare vjetore të tij, të hartuara në përputhje me standardet e kontabilitetit, me qëllim verifikimin e zbatimit të investimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në çdo rast kur ministria identifikon shkelje, ajo do t’ia komunikojë me shkrim, në mënyrë mjaft të hollësishme, vërejtjet dhe gjetjet e saj zotëruesit të lejes minerare, me kërkesën që punimet duhet të vazhdojnë sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Ligji i aplikueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjisllacioni shqiptar në fuqi. Ministria garanton se të drejtat e zotëruesit të lejes minerare sipas kësaj Marrëveshjeje që lidhen me shfrytëzimin e karrierave për një periudhë prej 99 vitesh dhe përdorimi i tokës për një periudhë prej 99 vitesh do të zgjasë dhe do të vijojnë të qëndrojnë në fuqi, pavarësisht çdo ndryshimi të dispozitave ligjore që lidhen me to, të aplikueshme në Shqipëri që do të hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje, e cila mund të lindë nga dhe në lidhje me këtë marrëveshje gjatë zbatimit të saj, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok ndërmjet palëve do të zgjidhet përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), nga një apo tre arbitra, që do të emërohen sipas rregullave të sipërpërmedura.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Paris, Francë dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

Neni 13

Bashkëpunimi

Ministria dhe zotëruesi i lejes minerare bien dakord që të bashkëpunojnë me qëllimin për të garantuar zbatimin e projektit siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera ndërmjet palëve duhet të dërgohen në adresat respektive të palëve.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas firmosjes së saj nga palët, dhe pasi ajo të miratohet me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe më pas të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar.

Për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar me Autorizimin e Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës nga;

Kristo Rodi
Drejtor i Përgjithshëm

Për Shoqërinë “SEASIF GROUP” sh.p.k.
Përfaqësuar nga administratori i shoqërisë

Sokol Kikino
Administrator

Aneksi nr.1

Koordinatat e sipërfaqes së përcaktuar si zonë minerare, pjesë e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1248, datë 13.10.2008, gurit gëlqeror të dhënë me dhe leje mjedisore nr.11, datë 6.8.2008:

Sipërfaqja = 970.000 m² = 97 ha

Nr. i pikës	Koordinatat	
	Y	X
1	46 45 000	43 73 180
2	46 45 090	43 73 220
3	46 45 080	43 73 750
4	46 45 360	43 73 910
5	46 45 220	43 74 180
6	46 44 250	43 75 320
7	46 43 870	43 74 980
8	46 44 820	43 3 870

Sipërfaqet e tokës bujqësore, (nëse evidentohen të tilla), brenda sipërfaqes së paraqitur me koordinatat e mësipërme, nuk janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje minerare.

LIGJ
Nr.10 164, datë 15.10.2009

PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar, me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e tij.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Autoriteti” është Autoriteti Rrugor Shqiptar, i krijuar sipas dispozitave të këtij ligji;
- b) “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e transportit rrugor;
- c) “Rrugët shtetërore” janë rrugët e klasifikuara në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor;
- ç) “Kodi Rrugor” është ligji nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) “DPRR” është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve;
- dh) “Rregullorja e DPRR-së” janë rregullat e vendosura nga ministria përgjegjëse, në përputhje me nenin 13 të Kodit Rrugor, e cila rishihet çdo dy vjet;
- e) “PKT” është Plani Kombëtar i Transportit;
- ë) “IT” është Instituti i Transportit, i ngarkuar me detyrat e mirëmbajtjes dhe të përditësimit të PKT-së;
- f) “Marrëveshja e shërbimit” është marrëveshja ndërmjet ministrit dhe Autoritetit, ku përcaktohen marrëdhënia ndërmjet palëve dhe funksionet, duke specifikuar detyrimet për fondet, planifikimin, mbarëvajtjen dhe raportimin;
- g) “Bordi” është bordi i menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- gj) “SD” është PKT-ja dhe strategjia sektoriale e transportit, si dhe çdo dokument tjetër, që mund të hyjë në veprim, në lidhje me transportin rrugor;
- h) “Menaxhim i rrjetit rrugor shtetëror” është programimi, planifikimi, financimi dhe mbikëqyrja në fushën e projektimit, të ndërtimit, të mirëmbajtjes dhe të rehabilitimit të rrugëve shtetërore.

Neni 3
Krijimi dhe statusi i Autoritetit

1. Autoriteti është person juridik, publik, i cili organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të statutit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të legjislacionit në fuqi.
2. Autoriteti ka selinë qendrore në Tiranë dhe drejtori rajonale në qarqe.
3. Mënyra e organizimit dhe struktura e Autoritetit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është menaxhimi i rrjetit rrugor shtetëror, në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor dhe të këtij ligji.

Neni 5

Funksionet e Autoritetit

1. Autoriteti ka këto funksione:
 - a) përmbushjen e detyrimeve, sipas Kodit Rrugor;
 - b) krijon qendrat e menaxhimit elektronik të trafikut dhe miraton statusin e tyre;
 - c) garanton siguri për të gjithë përdoruesit e rrugës në të gjitha veprimtaritë që organizon;
 - ç) krijon dhe mirëmban sistemin për administrimin e rrugëve shtetërore dhe të urave;
 - d) asiston në përditësimet vjetore dhe rishikimet pesëvjeçare të PKT-së për sektorin e transportit rrugor, në bashkëpunim me Institutin e Transportit;
 - dh) mirëmban dhe zbaton Manualin Shqiptar të Ndërtimit të Rrugëve dhe Specifikimet Teknike;
 - e) merr nisma për studime, kërkime shkencore dhe eksperimente për efikasitetin, trafikun, qarkullimin dhe sigurinë rrugore;
 - ë) përgatit programe afatmesme zhvillimi dhe programin vjetor të punës për ndërtimin, rikonstruksionin, mirëmbajtjen, ruajtjen, dhe zhvillimin e rrugëve shtetërore, në përputhje me përparësitë e përcaktuara në dokumentet strategjike.
2. Autoriteti përgatit një raport vjetor për ministrinë përgjegjëse dhe Këshillin e Ministrave, ku pasqyron veprimtarinë e kryer dhe planin në vazhdim. Raporti publikohet në internet.
3. Autoriteti mban librat kontabël, harton e publikon të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar, në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
4. Autoriteti raporton te ministri përgjegjës për veprimtarinë e realizuar, në përputhje me këtë ligj.

Neni 6

Ministri

1. Në përputhje me standardet, ministri mund të marrë nismën për kalimin e një pjese të rrugëve me ent pronar shtetin apo entet e tjera pronare, sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor, kur gjykon se funksionimi i tyre mund të kryhet më mirë nga Autoriteti sesa prej entit përkatës.
2. Ministri, në zbatim të politikave dhe përparësive të përcaktuara, lidh marrëveshje shërbimi me Autoritetin, ku përcaktohen kompetencat, të drejtat e detyrimit, nivelet e mbështetjes, përgjegjësitë dhe raportimi, si dhe treguesit kryesorë të performancës së shërbimit të kryer.

Neni 7

Organet e Autoritetit

Organet e Autoritetit janë:

- 1) Bordi;
- 2) Drejtori i përgjithshëm.

Neni 8

Bordi i menaxhimit

1. Bordi është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së Autoritetit.
2. Bordi përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e institucioneve përkatëse.

Përbërja e bordit është si më poshtë:

- a) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për transportin rrugor;
 - b) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat;
 - c) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për pronën shtetërore;
 - ç) 1 përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për pushtetin vendor;
 - d) 1 përfaqësues nga shoqata e kontraktorëve;
 - dh) 1 përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;
 - e) 1 përfaqësues nga Shoqata e Inxhinierëve Konsulentë.
3. Mbledhja e bordit zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
4. Bordi merr vendimet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.
5. Në rast largimi të anëtarëve të bordit, zëvendësimi i tyre bëhet në përputhje me pikat 2 dhe 7 të këtij neni.
6. Pagesa e anëtarëve dhe kryetarit të bordit, e drejtorit të përgjithshëm dhe e punonjësve të autoritetit, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Anëtarët e Bordit emërohen për një afat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
8. Bordi, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh zëvendëskryetarin. Kryetari është përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për transportin rrugor.

Neni 9

Kriteret dhe kushtet për t'u zgjedhur anëtar i bordit

1. Anëtarët e bordit duhet të jenë personat me përvojë në lidhje me rrugët, transportin, çështjet industriale, tregtare, financiare, juridike apo mjedisore.
2. Anëtari i bordit duhet të plotësojë këto kushte:
 - a) të jetë shtetas shqiptar dhe të banojë në Republikën e Shqipërisë;
 - b) të ketë arsimin e lartë dhe përvojën, sipas pikës 1 të këtij neni;
 - c) të mos jetë i dënuar penalisht;
 - ç) të mos jetë shkarkuar nga detyra apo të mos ketë marrë masa disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës;
 - d) të mos ketë konflikt interesash me detyrën.

Neni 10

Largimi nga detyra

- Anëtari i bordit lirohet nga detyra, me vendim të organit që e ka emëruar, kur:
- a) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një krimi;
 - b) bëhet i paaftë për të kryer detyrën për shkak sëmundjeje;
 - c) mungon brenda një viti në më shumë se në 1/3 e mbledhjeve të Bordit;
 - ç) vërtetohet se nuk përmbush më detyrimet e shkronjës "d" të nenit 9 të këtij ligji;
 - e) në mënyrë të përsëritur, mbi dy herë radhazi, pengon formimin e kuorumit të nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes së bordit.

Neni 11

Detyrat dhe të drejtat e bordit

- Bordi është organi i vetëm përgjegjës për:
- a) përcaktimin e politikave të biznesit të Autoritetit;
 - b) vendimet, që rregullojnë veprimtarinë e Autoritetit;
 - c) miratimin e rregullores së brendshme të Autoritetit;
 - ç) miratimin e programeve të brendshme vjetore dhe të buxhetit korrespondues të Autoritetit.

Neni 12
Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm

1. Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm janë:
 - a) siguron drejtimin dhe administrimin efektiv të Autoritetit;
 - b) zhvillon, zbaton e realizon veprimtaritë e përcaktuara nga ky ligj;
 - c) përgatit dokumentacionin e Autoritetit për burimet njerëzore dhe i administron këto burime dhe kualifikimin e tyre;
 - ç) përfaqëson Autoritetin në ministrinë përkatëse dhe në marrëdhënie me të tretë;
 - d) siguron zbatimin e politikave të Autoritetit dhe të kërkesave të tjera ligjore për këtë Autoritet;
 - dh) siguron të dhëna për bordin drejtues për çështjet, që lidhen me Autoritetin;
 - e) bashkëpunon në hartimin e politikave, që synojnë përmirësimin e veprimtarisë së Autoritetit dhe vë në dijeni bordin për këto politika;
 - ë) zbaton detyra të tjera, të caktuara nga bordi;
 - f) emëron nëpunësit dhe personelin e nevojshëm të Autoritetit, të përzgjedhur nga një tërësi kandidatësh të kualifikuar, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kodin e Punës;
 - g) merr pjesë në mbledhjet e bordit pa të drejtë vote.
2. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga Kryeministri me propozimin e ministrit dhe nuk është anëtar i bordit. Drejtori i përgjithshëm është menaxheri i përgjithshëm i Autoritetit dhe vepron sipas autoritetit të deleguar nga bordi, duke i raportuar drejtpërdrejt atij.
3. Drejtori i përgjithshëm emëron drejtorët e drejtorive rajonale në qarqe.
4. Drejtori i përgjithshëm zbaton politika për forcimin e Autoritetit dhe të përgjegjësive, informon stafin për nivelin e punës së tyre dhe kryen detyrat publike, duke ruajtur mirëbesimin, integritetin dhe profesionalizmin e shërbimeve të kryera nga Autoriteti.

Neni 13

Financimi

1. Autoriteti, për realizimin e funksioneve të parashikuara në këtë ligj, harton buxhetin vjetor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
2. Ministri, në përputhje me kushtet për të cilat është rënë dakord në marrëveshjen e shërbimit, për çdo vit financiar, autorizon përdorimin e fondeve të miratuara në Buxhetin e Shtetit për funksionimin e Autoritetit.

Neni 14

Dispozita kalimtare

Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, transformohet në Autoritetin Rugor Shtetëror. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe funksionet e DPRR-së do të vazhdojnë të ushtrohen prej saj, deri në fillimin e veprimtarisë së organeve të Autoritetit.

Neni 15

Dispozita e fundit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në zbatim të pikave 1 dhe 3 të nenit 3, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6312, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 165, datë 15.10.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E MOSHËS SË DALJES NË PENSION TË PUNONJËSVE
TË NËNTOKËS**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Punonjësit e nëntokës, me periudhë pune të klasifikuar në kategorinë e parë, sipas dispozitave të kreut I të vendimit nr.526, datë 20.12.1958 të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punës në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, kanë të drejtë të kërkojnë pension pleqërie kur:

- a) arrijnë moshën 60 vjeç;
- b) kanë periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet, nga të cilat jo më pak se 15 vjet punë në nëntokë.

Neni 2

Pensioni llogaritet sipas rregullave të përcaktuara për pensionet e pleqërisë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 3

Efektet financiare të këtij ligji, deri në mbushjen e moshës, sipas nenit 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6313, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 166, datë 15.10.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8306, DATË 14.2.1998 “PËR STRATEGJINË E PRIVATIZIMIT TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Paragrafi i parë i nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

“Sektorë me rëndësi të veçantë të ekonomisë janë: industria e energjetikës dhe e mineraleve, e naftës dhe e gazit, postat, telekomunikacionet, pyjet dhe ujërat, rrugët automobilistike e hekurudhore, portet detare, aeroportet, transporti ajror e hekurudhor.”.

Neni 2

Në nenin 13 fjalët “(me përjashtim të sektorit bankar dhe të sigurimeve)” shfuqizohen.

Neni 3

Neni 14 shfuqizohet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6314, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

VENDIM
Nr.984, datë 30.9.2009

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE DHE
“MASTER I NIVELIT TË PARË”, ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009-
2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010, të jetë 7055. Kjo kuotë të ndahet, si më poshtë vijon:

a) Kuota e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë (DND)	2640,
b) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i nivelit të parë” (MNP)	4145,
c) Kuota për programe të dyta studimi	100,
ç) Kuota për transferimin e studimeve	100,
d) Kuota për të huajt	50,
dh) Kuota për të verbërit (të veçanta)	20.

2. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të përbëhet nga:

a) Kuota e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë (DND), për kandidatët brenda territorit të vendit	2376;
b) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë (DND), për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit	264;
c) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), për kandidatët brenda territorit të vendit	3 730;
ç) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit	415.

3. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë (DND), me kohë të plotë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqitur në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit Master i nivelit të parë, (MNP), me kohë të plotë, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqitur në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë, sipas shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 2 të këtij vendimi, të ndahen nëpërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje. Administrimi i këtyre kuotave kryhet nga autoritetet përgjegjëse respektive të këtyre vendeve, të cilat sjellin listat e kandidatëve fitues, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila ua përcjell ato institucioneve publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve të ndryshme publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi, janë në masën 10 për qind të kuotës përkatëse, të dhënë në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Kuota e pranimeve për të verbërit ndahen për kandidatët me statusin e të verbërit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pasi merret mendimi i Shoqatës Kombëtare të të Verbërve.

7. Kuota e pranimi për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij vendimi, të administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kuota shpërndahet në bazë të

marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si edhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga kandidatët e interesuar.

8. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi dhe transferimi i studimeve të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës bazuar edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë do të funksionojë në vitin e parë për vitin akademik 2009-2010, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të kandidatëve dhe i bëjnë publike paraprakisht.

11. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, (DND) dhe master i nivelit të parë me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, sipas tabelës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010, dhe që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër/të shurdhër, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, e të ish-të përndjekurve politike, paguajnë një kuotë, në masën, 50 për qind të tarifës së shkollimit.

Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që i përkasin po këtyre shtresave sociale.

13. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë rregullisht studimet.

14. Në çdo program studimi në ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, studentët e vitit të parë, që kanë përfunduar shkëlqyeshëm ciklin e parë të studimeve, dhe studentët e vitit të dytë, që kanë përfunduar shkëlqyeshëm vitin e parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik 2009-2010.

Në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, për lëndët fizikë, matematikë apo kombinimet e tyre, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, studentët që në ciklin e parë kanë pasur mesatare jo më të ulët se nota 8 (tetë), nuk paguajnë tarifën e shkollimit.

15. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që ndjekin një program të dytë studimi, në ciklin e dytë të studimeve DND dhe “Master i nivelit të parë” (MNP) janë sipas tabelës nr.4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

16. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

17. Transferimet e studimeve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhënë në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore, në statut dhe rregulloret e tyre.

18. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi, apo nga programe të mëparshme studimi, të ciklit të dytë, në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

19. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të parealizuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

20. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

6817

TABELA NR.1

Nr.	Emërtimet e programeve të studimit	UT		UPT	UBT	USH	UE	UD	UGJ	UV	Σ
1.	Biologji mjedisore	30									30
2.	Biologji molekulare	20									20
3.	Fizikë	20									20
4.	Bioteknologji molekulare dhe industriale	20									20
5.	Kimia industriale dhe mjedisore	20									20
6.	Inxhinieria e proceseve kimike	20									20
7.	Shkecat dhe teknologjitë ushqimore	20									20
8.	Analiza kimike dhe vetitë e lëndës	20									20
9.	Matematikë	20								50	70
10.	Inxhinieri matematike dhe informatike	20									20
11.	Informatikë	20									20
12.	Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor e turistik	80									80
13.	Përkthim teknik-letrar dhe interpretim	80									80
14.	Gjuhësi	100									100
15.	Histori	50									50
16.	Arkeologji	50									50
17.	Trashëgimi kulturore	50									50
18.	Marrëdhënie ndërkombëtare	20									20
19.	Gazetari	100									100
20.	Përkatësi gjinore dhe zhvillim	60									60
21.	Psikolog shkollor/organizacional	30									30
22.	Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdhënieve	30									30
23.	Filozofi sociale	60									60
24.	Shkenca politike-teori politike	50									50
25.	Sociologji e zhvillimeve shoqërore	40									40
26.	Punë sociale	100									100
27.	Inxhinieri elektronike			20							20
28.	Inxhinieri e telekomunikacionit			20							20
29.	Inxhinieri informatike			20							20
30.	Inxhinieri elektrike			40							40
31.	Inxhinieri mekanike			55							55
32.	Inxhinieri materiale			20							20
33.	Inxhinieri tekstile dhe mode			20							20
34.	Inxhinieri gjeologjike			80							80
35.	Inxhinieri e burimeve natyrore			80							80
36.	Inxhinieri gjeofizike			20							20
37.	Inxhinieri mjedisi			60							60
38.	Inxhinieri ndërtimi			120							120
39.	Inxhinieri hidroteknikë			30							30
40.	Inxhinieri gjeodezi			30							30
42.	Inxhinieri agrare				120						120
43.	Agromjedis dhe ekologji				30						30
44.	Inxhinieri agroushqimore				40						40
45.	Inxhinieri përpunim druri				20						20
46.	Inxhinieri pyjore				20						20
47.	Ekonomi dhe politika agrare				50						50
48.	Menaxhim agrobiznesi				50						50
49.	Inxhinieri matematike			40							40
50.	Inxhinieri fizike			40							40
51.	Turizëm i qëndrueshëm					30					30

52.	Mbrojtje mjedisi						30				30
53.	Matematikë e zbatuar						25				25
54.	Trashëgimi kulturore						30				30
55.	Studime shqiptare					90					90
56.	Ekonomi biznesi							60			60
57.	Menaxhim							60			60
58.	Politikë dhe administrim							60			60
59.	Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike								25		25
60.	Inxhinieri navale		820							25	25
	Totali	1130		695	330	120	85	180	25	75	2640

TABELA NR.2

Nr.	Emërtimet e programeve të studimit	UT	UE	USH	UV	UK	UGJ	UBT	Σ
1.	Mësuesi në CLAB në gjuhë-letërsi		60	60		60	50		230
2.	Mësuesi në CLAB në biologji-kimi		70	60			50		180
3.	Mësuesi në CLAB në gjuhë italiane		20	60	80				160
4.	Mësuesi në CLAB në gjuhë gjermane		20	60					80
5.	Mësuesi në CLAB në gjuhë frënge		30	60					90
6.	Mësuesi në CLAB në gjuhën angleze		60	60	80	40	50		290
7.	Mësuesi në CLAB në matematikë-fizikë		40	60	30	20	50		200
8.	Mësuesi në CLAB në matematikë-informatikë		20	60			50		130
9.	Mësuesi në CLAB në histori-gjeografi		60				50		110
10.	Mësuesi në AM në shkenca sociale					40			40
11.	Mësuesi në AM në gjuhë angleze	150							150
12.	Mësuesi në AM në gjuhë frënge	80							80
13.	Mësuesi në AM në gjuhë gjermane	80							80
14.	Mësuesi në AM në gjuhë italiane	80							80
15.	Mësuesi në AM në gjuhë-letërsi	200	30			35			265
16.	Mësuesi në AM në histori	100							100
17.	Mësuesi në AM në gjeografi	100							100
18.	Mësuesi në AM në kimi	20	30						50
19.	Mësuesi në AM biologji	20	30						50
20.	Mësuesi në AM në fizikë	20							20
21.	Mësuesi në AM në matematikë	20			30				50
22.	Mësuesi në AM në informatikë	20			30				50
23.	Menaxhim infermieror	150							150
24.	Teknik laborator	70							70
25.	Mami	50							50
26.	Teknologji informacioni	20							20
27.	Zhvillimi i integruar rural					30			30
28.	Operacione industriale dhe navale				30				30
29.	Edukatë qytetare dhe gjeografike		70						70
30.	Edukatë qytetare dhe histori		70						70
31.	Redaktim		30						30
32.	Drejtimit dhe administrim arsimit	40							40
33.	Qeverisje dhe politikë publike	50							50
34.	Këshillim psikologjik	40							40
35.	Orientim profesional	40							40
36.	Punë sociale	120							120
37.	Filozofi praktike dhe humane	40							40
38.	Analizë e politikës sociale	120							120
39.	Teknologji e avancuar në hortikulturë							30	30
40.	Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia							30	30
41.	Biznes blektoral							30	30
42.	Teknologji e kultivimit të bimëve							30	30
43.	Menaxhim mjedisi							30	30
44.	Menaxhim i ndërmarrjeve							30	30
45.	Ekonomi dhe agrobiznes							30	30
46.	Ekonomi dhe politikë agrare							30	30
47.	Redaktori	70							70
48.	Gjeomorfologji	20							20
49.	Arkivistikë	100							100
50.	Sipërmarrje dhe turizëm				70				70
51.	Administrim publik				70				70
52.	Përkthim dhe interpretim në gjuhë gjermane			20					20
	Gjithsej	1820	640	500	420	225	300	240	4145

TABELA 3

Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, DND, në vitin akademik 2009-2010:

a) në Universitetin e Tiranës:

I. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Fizikë	44 000 lekë
ii) Matematikë	40 000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	56 000 lekë.

II. Fakultetin e Gjuhëve të Huaja: 48 000 lekë.

III. Në fakultetin Histori-Filologji:

i) Arkeologji	72 000 lekë
ii) Trashëgimi kulturore	72 000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	48 000 lekë.

IV. Në Fakultetin e Shkencave Sociale: 60 000 lekë

b) Në Universitetin Politeknik të Tiranës:

I. Në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit:	56 000 lekë
II. Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike	48 000 lekë
III. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike	40 000 lekë
IV. Në fakultetin e Gjeologji Miniera	40 000 lekë
V. Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit	60 000 lekë.

c) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:

I. Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit	36 000 lekë
II. Në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit	40 000 lekë
III. Në Fakultetin e Shkencave Pyjore	36 000 lekë
IV. Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit	48 000 lekë.

d) Në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë	40 000 lekë
e) Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	50 000 lekë
f) Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës	50 000 lekë
g) Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan:	
i) Matematikë e zbatuar	40 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	50 000 lekë.

Tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit “Master i nivelit të parë” me kohë të plotë, në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009-2010:

a) Për programet e studimit “Master i nivelit të parë” në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, të jetë:

i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre	30 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	4 000 lekë

b) Për programet e studimit “Master i nivelit të parë” në mësuesi për arsimin e mesëm, të jetë:

i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre	40 000 lekë
ii) të gjitha programet e tjera	45 000 lekë
c) Për të gjitha programet e tjera “Master i nivelit të parë”	60 000 lekë.

TABELA NR.4

Tarifat vjetore të shkollimit për programet e dyta të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, DND, në vitin akademik 2009-2010:

a) Në Universitetin e Tiranës:

I. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Fizikë	95 000 lekë
ii) Matematikë	95 000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	150 000 lekë
II. Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja	95 000 lekë
III) Në Fakultetin Histori-Filologji:	
i) Arkeologji	200 000 lekë
ii) Trashëgimi kulturore	200 000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	95 000 lekë
IV. Në Fakultetin e Shkencave Sociale	95 000 lekë

b) Në Universitetin Politeknik të Tiranës:

I. Në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit	200 000 lekë
II. Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike	200 000 lekë
III. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike	150 000 lekë
IV. Në Fakultetin e Gjeologji-Miniera	150 000 lekë
V. Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit	250 000 lekë

c) Në Universitetin Bujqësor të Tiranë:

I. Në fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit	150 000 lekë
II. Në fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit	200 000 lekë
III. Në fakultetin e Shkencave Pyjore	95 000 lekë
IV. Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit	95 000 lekë

d) Në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë	95 000 lekë
e) Në universitetin “Luigj Gurakuqi, Shkodër	95 000 lekë
f) Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës	95 000 lekë
g) Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	
i) Matematikë e zbatuar	80 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	95 000 lekë

Tarifat vjetore të shkollimit për programet e dyta të studimit “Master nivelit të parë” me kohë të plotë, në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009-2010:

a) Për programet e studimit “Master i nivelit të parë” në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, të jetë:

i) Për lëndën fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre	60 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	80 000 lekë

b) Për programet e studimit “Master i nivelit të parë” në mësuesi për arsimin e mesëm, të jetë:

i) Për lëndën fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre	80 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	100 000 lekë
c) Për programet e tjera “Master i nivelit të parë”:	
i) Në Fakultetin e Infermierisë	200 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	100 000 lekë.

UDHËZIM

Nr.1456/2, datë 29.9.2009

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1456, DATË 28.7.2009 “PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË PËRKUJDESIT SHOQËROR”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 18 pika 1 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 5 kreu II dhe pikës 4 kreu XI të vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.1456, datë 28.7.2009 të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të përkujdesit shoqëror”, pas germës “a” të pikës 3, shtohet germa “a/1” me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“a/1.shqyrton dokumentet provuese për drejtuesin teknik, sipas përcaktimit të germës “a”, pika 2, kreu III i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, si: diplomën universitare në degët mjekësi, ekonomi dhe shkenca sociale, apo diploma masteri të nivelit të dytë në këto degë.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera**

VENDIM
Nr.28, datë 2.10.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 26.5.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.9 Akti, që i përket:

KËRKUES:GRAMOZ KENELLA, përfaqësuar nga avokat Saimir Vishaj, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.509, datë 12.11.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.48, datë 13.12.2006, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “trafëkim i armëve dhe municionit”, në bashkëpunim më shumë se një herë dhe, në bazë të nenit 278/a/2 të Kodit Penal (KP), e ka dënuar me 10 vjet burgim. Në zbatim dhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kjo gjykatë e ka dënuar përfundimisht me 6 vjet e 8 muaj burgim.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.22, datë 06.04.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.48, datë 13.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke e deklaruar kërkuarin fajtor për veprën penale të “moskallëzimit të krimit” dhe e ka dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim.

Prokurori i Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë ka paraqitur rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.509, datë 12.11.2008, ka vendosur prishjen e vendimit nr.22, datë 06.04.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr.48, datë 13.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Kërkuesi Gramoz Kenella, përpara Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), kërkon shfuqizimin e vendimit nr.509, datë 12.11.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me pretendimin se ky vendim është marrë nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor, lidhur me të drejtën e mbrojtjes, duke parashtruar këto argumente:

- Rekursi i ushtruar nga ana e prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nuk i është komunikuar dhe për pasojë, ai është privuar nga pjesëmarrja në gjykim në Gjykatën e Lartë.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në mungesë të përfaqësuesit të kërkuesit në gjykim, ka rënduar pozitën e këtij të fundit për të lehtësuar pozitën e ndonjë të pandehuri tjetër në këtë procedim.

- Mungesa e mbrojtjes është një shkelje esenciale e procesit penal, çka e bën këtë proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

II

Gjykata i vlerëson pretendimet e kërkuesit në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, se çfarë detyrimesh i ngarkon Gjykatës së Lartë respektimi i së drejtës së mbrojtjes.

Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar, se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktorialiteti dhe lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përbëjnë në vetvete elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për respektimin e këtyre parimeve gjykatat duhet të përmbushin një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj., me synimin që të realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata (Shih vendimet nr.13, datë 21.07.2008 dhe nr.16, datë 08.06.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

Duke iu referuar në mënyrë të veçantë jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Gjykata përgjithësisht ka mbajtur qëndrimin që seancat gjyqësore të mos zhvillohen pa praninë e një avokati. Për shkak të zhvillimit të debatit gjyqësor për çështje të ligjit, pjesëmarrja e të pandehurit në gjykimin e çështjes në gjykatat më të larta, nuk është konsideruar e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë pasur rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë. Mbi këtë bazë është konsideruar i mjaftueshëm njoftimi i avokatit mbi ankimin e ushtruar në shkallët më të larta të gjykimit. Por, Gjykata e ka konsideruar të palejueshëm vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit në rastet kur në seancë gjyqësore nuk paraqitet as avokati dhe as i pandehuri (Shih vendimin nr.23, datë 13.10.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata ka konfirmuar se nisur nga natyra e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë dhe të përqendrimit të saj në probleme të ligjit, pa ndihmën e një avokati, procesi nuk mund të kontribuojë në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndrojnë në thelb të mosmarrëveshjeve (Shih vendimin nr.25, datë 30.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedurat strikte të gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë, se palët, duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (Shih vendimin nr.5, datë 04.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese). Në bazë të nenit 435, paragrafi 2 të KPP kur i pandehuri nuk ka mbrojtës, kryetari i kolegjit duhet të caktojë një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit.

Gjykata, lidhur me gjykimin në Gjykatën e Lartë, ka vlerësuar edhe më parë, se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i akuzuari nuk është e njëlllojtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 13.10.2005). Në rastin e parë, prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore nuk është e domosdoshme dhe Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes për shkak se argumentet ligjore, ai i ka

depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj dhe vendimi i gjykatës më të ulët nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit. Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi zhvillohet pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij.

Në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se pranë Gjykatës së Lartë ka paraqitur rekurs prokurori i Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë. Nga dosja gjyqësore rezulton se dëftesa e komunikimit të rekursit (nr.94, më datë 03.05.2007) ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i është përcjellë avokatit, i cili shprehet në të njëjtën dëftesë se: “nuk e kam unë këtë çështje”. Nga dosja gjyqësore konstatohet se ky avokat ka qenë mbrojtës i kërkuesit gjatë gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kurse në gjykimin në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, mbrojtës i kërkuesit ka qenë një avokat tjetër.

Gjykata e Lartë, në seancën gjyqësore të datës 01.10.2008, pasi ka bërë verifikimet e pjesëmarrjes së palëve, ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore, për arsye se ishte paraqitur vetëm mbrojtësi i një prej të pandehurve në proces dhe njoftimin me shpallje për seancën e ardhshme. Në seancën gjyqësore të datës 29.10.2008, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur vazhdimin e gjykimit të çështjes dhe e ka shqyrtuar atë në mungesë të kërkuesit dhe mbrojtësit të tij. Vendimi i kolegjit e ka përkeqësuar pozitën e kërkuesit për shkak se ky vendim ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Siç u përmend dhe më sipër, Gjykata e ka konsideruar cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjykimin pa praninë e mbrojtësit të të gjykuarit. Interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, për të pandehurin që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohet rëndim i pozitës së tij në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, për çështjen në shqyrtim ishte e domosdoshme marrja e masave për të mos lejuar zhvillimin e seancës në mungesë të avokatit mbrojtës të të pandehurit, si e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes këtij të fundit, të realizonte të drejtën për t’u mbrojtur.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson, se në procesin e zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është cenuar e drejta e kër

kuesit për t’u mbrojtur në procesin penal, si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.509, datë 12.11.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë përsa i përket të gjykuarit Gramoz Kenella.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Admir Thanza, Sokol Sadushi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 3.11.2009
 Doli nga shtypi më 5.11.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 48 lekë